



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.51

16 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.341, datë 27.2.2008

Për miratimin e planit të veprimit, sipas raportit përfundimtar për
reformimin e kapaciteteve institucionale dhe shndërrimin e
Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Ent Publik 2273

VENDIM
Nr.341, datë 27.2.2008

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT, SIPAS RAPORTIT PËRFUNDIMTAR PËR
REFORMIMIN E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE DHE SHNDËRRIMIN E
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE NË ENT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit, sipas raportit përfundimtar, për reformimin e kapaciteteve institucionale dhe shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Ent Pulik, bazuar në vizionin e njësisë së reduktuar, të centralizuar dhe kontraktuese, sipas materialit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për planifikimin e fondeve të nevojshme dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**FORMIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE
DHE TRANSFORMIMI I DPRR NË NJË ENT PUBLIK**

LISTA E SHKURTIMEVE

ANTP	Plani i Transportit Nacional ne Shqiperi
ARSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
CEO	Oficeri Drejtues
DFR	Raporti Perfundimtar Draft
FAPMS	Sistemi Llogarive Financiare dhe Monitorimit te Projektit
GIS	Sistemi i informacionit gjeografik
DPRR	Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve
HR	Burimet Njerezore
HRM	Menaxhimi i Burimeve Njerezore
IFI	Institucioni Nderkombetar Financues
IT	Teknologjia e Informacionit
ITS	Instituti I Studimeve te Transportit
MoF	Ministria e Finances
MPPTT	Ministria e Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit
MTEF	Kuader afat mesem shpenzimesh
OMIS	Menaxhimi Direkt dhe Sistemi I Informacionit
OSP	Plani Strategjik Veprues
PIT	Njesia e Zbatimit te Projekteve
QA	Sigurimi Cilesise
RAMS	Sistemi i Menaxhimit te Aseteve Rrugore
RD	Drejtori Rajonale
RIT	Njesia e Zbatimit te Reformes
ROW	E Drejta e Rruges
SOP	Mundesite e Planit Strategjik
TA	Asistenca Teknike
TOR	Termet e References
WB	Banka Boteror

1.Historiku dhe objektivat e projektit

1. Historiku

1. Nje propozim I ri dhe nje proces reforme per zhvillimin e sektorit te transportit eshte percaktuar tashme ne Planin e Transportit Nacional Shqiptar (ANTP), financuar nga Bashkimit European. Qeveria ka miratuar studimin e (ANTP) dhe ne Qershor 2007 Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) publikoje nje Strategji per Sektorin e Transportit i cili konfirmon edhe nje here drejtimin strategjik dhe politik ne perputhje me (ANTP). MPPTT ka treguar se strukturimi dhe procesi reformimit per DPRr eshte pergjegjesisht i pranueshem dhe ka marre masa paraprake ne zbatim te rekomandimeve ne ANTP perfshir ketu reduktimin e njesive operuese ne DPRr.

2. Asistenca Teknike (TA) eshte miratuar nga Qeveria e Shqiperise me mbeshtetjen e Bankes Boterore (BB) per te asistuar perfaqesuesit e MPPTT qe te percaktojne me tej zbatueshmerine me perpikmeri te procesit dhe strukturen e DPRr. Nje nder rezultatet kryesore te TA eshte pergatitja e plan veprimit te reformes, e detajuar kjo ne menyre te tille qe te transformoje strukturen ekzistuese organike dhe operuese duke krijuar nje organike shume here me moderne dhe efektive per rruget. Qellimi i shprehur me lart do zbatohet me mbeshtetjen e ndihmen se donatoreve komunitare nese do te shihet e domosdoshme, subjekt I nje kerkese per asistence nga autoritetet. Qellimi eshte qe te siguriimi I nje 'harte rrugore' e cila do beje te mundur transformimin e DPRr ne ent publik nga me efektivet dhe moderne ne rajon.

3. Rekomandimet qe shprehen ne kete raport nenvizojne pergjithesisht idene e konsulentit per masat qe duhen marre ne realizimin e reformes se propozuar. Ato bazohen ne praktikat me te mira qe kane te bejne me sektorin e rrugeve ne mbare boten, konsultime me aktoret kryesore si brenda dhe jashte vendit si dhe rekomandimet e studimit te ANTP dhe asistencave te tjera teknike. Komentet e

qeverise per Draft Raportin Perfundimtar (DFR) kane shprehur po ashtu nevojën per zbatueshmerine e ketij plani dhe konkretisht zhvillimin me metejshem te procesit te reformes informacione te shprehur ne kete raport. Plan i veprimit i treguar ne Seksionin IV te raportit propozon krijimin e nje Njesie per Zbatimin e Reformes (RIT). Nen drejtimin e MPPTT, RIT-i i pergjigjet Njesise se Menaxhimit, qe kryesohet nga Ministri i MPPTT dhe qe gezon autoritetin per te propozuar dhe zbatuar me perpikmeri rekomandimet e ketij raporti, me qellim perfundimin dhe kompletimin e objektivave te kesaj reforme deri ne muajin Dhjetor te vitit 2009.

2. Objektivat e Projektit

4. Objektivi i pergjithshem i TA mbetet identifikimi i te gjithe hapat te nevojshem dhe pergatitjes se nje Plan Veprimi per transformimin e DPRr ne nje Ent Publik, qe kontraktin sherbimet e nevojshme te kryera ne menyre efektive nga sektori privat.

5. Objektivat dytesore te identifikuar si me poshte jane:

- Konfirmimi, ne bashkepunim me perfaqesuesit e MPPTT, i organikes me te pershtatshme per strukturen e re te DPRr, e bazuar kjo ne vizionin e njesise se reduktuar, te centralizuar dhe kontraktuese;

- Identifikimi i ndryshimeve te kerkuara ne kuadrin institucional dhe rregullator, te nevojshem per transformimin e DPRr ne nje Ent Publik me financa te qendrueshme, me fonde rrjedhese te perhershme te kuadruara mire keto ne Kornizen e Shpenzimeve Afat-Mesme (MTEF);

- Identifikimi, ne bashkepunim me MPPTT, te aktiviteteve te njesive dhe individeve brenda strukture se re organizative perfshire ketu procesin aktual dhe te propozuar, dhe te perpiloj plane me qellimi afat mesme;

- Identifikimi i dobesite te vecanta formuese ne organike se bashku me gjithe trajnimet e stafit, te domosdoshem per kuadrin afat mesem;

- Te pergatise dokumentacionin e nevojshem per organiken e re ne lidhje me (i) Statutin apo Statusin e Nismes, akte te brendshme dhe rregullatoret operues, sic jane plani i biznesit dhe (ii) te pershkruaje ne keto dokumenta apo rregullore se si pasqyrohen te tilla ceshtje ne organike ne lidhje me ndertimin e rrugeve, rehabilitimin, dhe veprimtarite e mirembajtjes si dhe praktikave perforcuese;

- Te pergatise Termat e References (TOR), aty ku nevojiten, per asistencë teknike ne menyre qe te ndermjetesohet implementimi i hapave te mesiperme ne fazen pasardhese te reformes;

3. Kohezgjatja e Projektit

6. Asistenca Teknike ka zgjatur rreth kater muaj, me perthithjen e informacioneve nga Specialisti i Reformes Institucionale gjate dhjete jave. Rezultatet me kryesore permblidhen ne:

- Raporti Paraprak brenda kater javeve qe nga nenshkrimi i kontrates duke siguruar nje permblidhje te strukture se re te propozuar dhe gjithe problemeve /dobesive te identifikuar ne DPRr;

- Draft Raporti Perfundimtar qe perfshin:

- Nje pershkrim te shkurter te sherbimit te kryer,

- Propozime ne kuadrin institucional me kerkesat per stafin,

- Plan i veprimit per transformim ne veprime specifike dhe afate kohore per permbushjen e tyre,


- Ceshtje qe ndikojne ne zbatimin e reformes,

- Nje pershkrim i Asistences Teknike per mbeshtetjen e nevojshme ne implementim;

- Raporti Perfundimtar pergatitet pas dy javeve nga marrja e komenteve te MPPTT dhe BB.

7. Ky raport mundeson: (i) kuadrin organik dhe mjedisin operues te propozuar, (ii) nje plan veprim per perfundimin e transformimit, (iii) nje diskutim per ceshtjet me kritike te zbatueshmerise, dhe (iv) TeR te propozuara per mbeshtetjen e MPPTT qe do ndermarre transformimin dhe do pajise ARA-n me teknologji dhe aftesite e nevojshme per nje performance sa me te mire ne te ardhmen.

FIGURA 1 SHTRIRJA NE KOHE E PROJEKTIT




II. PRAKTIKAT EKZISTUESE

4. Fushat e Veprimit

8. Performanca ne sektorin e rrugeve ne Shqiperi eshte krahasuar me performancen e agjensive te medha te vendeve te tjera ne ballkan si dhe ato ne Europe, Azi dhe Ameriken e Veriut. Ne sherbim te ketij krahasimi faktore te jashtem si dhe faktor brenda agjesive te rrugeve jane marr ne konsiderat. Fushat e analizuara jane treguar ne figuren e meposhtme.

Figura 2 Kategorite e Vleresimt



performance te larte pergjithesisht shoqerohen nga karakteristikat e meposhtme:

- **Kuadri Rregullator** qe karakterizohet nga (i) politikat e sektorit rrugor qe rrjedhin nga nje autoritet strategjik planifikues dhe qe drejtohen drejt arritjes se rezultatit themelor dhe (ii) nje ligj apo rregullore rrugore te bashkekohore, qe nenvizon sa me mire pergjegjesite e autoritetit rrugor dhe bazen ligjore per te zbatuar keto pergjegjesi;

- **Mekanizmat financiare** qe (i) sigurojne financimin e pershtatshem per sektorin nga nje burim i qendrueshem i perdoruesit rrugor dhe fondet e qeverise, shpesh ne formen e te ardhurave rezerve qe vijne nga tarifat e perdoruesve rrugore, dhe (ii) qe jane bazuar ne nje planifikim te nje shkalle me te gjere, per te promovuar aplikimin sa me efektiv te fondeve;

- **Struktura organike dhe menaxhuese** qe (i) fuqizon pjesemarjen e perdoruesit rrugor dhe aksionereve, se bashku me perfaqesues te qeverise, ne nje Bord Drejtores qe menaxhojne dhe drejtojne organiken e sektorit rrugor(ii) nenvizon mire sherbimet qe mund te permbushen ne menyre efektive nga sektori privat dhe (iii) prokuron, supervizon dhe kontrollon keto sherbime ne perputhje me praktikat industriale me te mira;

- **Sistemet e Informacionit** qe jane (i) projektuar ne perputhje me standartet te percaktuara te teknologjise se informacionit (IT), (ii) permbajne sistemet e planifikimit dhe informacionit dhe te dhenat baze te nevojshme per menaxhimin ne ndjekje te kopetencave te veta, dhe (iii) te siguroje akses ne gjithe nivelet e organikes per infomacion te autorizuar dhe te nevojshem;

- **Burimet Njerezore** qe (i) bazohen ne linja me te qarta pergjegjesisht dhe komunikimi (ii) mbesheten nga programe zhvilluese dhe efektive per ecurine e metejshe me burimeve njerezore dhe (iii) punesohen ne nivelet e tregut per kompensimin e tyre;

- Mekanizmat qe sigurojne **Sherbimet Themelore** duke nderthurur ne menyre te perstateshme rendesine e tyre dhe financimin e duhur per planifikim, projektim rruges, supervizionin e punimeve dhe mirembajtjen, te cilat jane shprehur qarte ne relacionet manuale dhe specifikimet teknike.

5. Analizim per Veprimtarine e DPRr

10. Nga analizat e kryera ne DPRr ne gjashte fushat e zbatimit duket se, megjithese organika i ushtron mire kopetencat e veta, ne disa fusha te caktuara serish dalin mangesi ne hapesirat strukture dhe operuese per te patur rezultate te larta. Ne paragrafin e meposhtem krahasohen karakteristikat ekzistuese te DPRr me organikat me te perparuara. Propozimet e reformes kane ndermend te ndihmojne organiken e sektorit rrugor per te pershtatur sa me mire keto karakteristika.

11. **Funksioni planifikim** ne DPRr nuk ekziston. Rruget jane perzgjedhur per tu rregulluar

teresisht ne baze te opinionit te perfaqesuesve zgjedhore lokale dhe nacionale me shume pak njohuri teknike ne fushen perkatese. Pa dyshim qe projekte e nevojshme jane identifikuar ne baze te ketij procesi por ato jo gjithmone i kthejne perdoruesve te rruges rezultatin e pritur dhe nuk konsiderohen si pjese e planeve strategjike per nje rrjet rrugor te integruar. Pa nje proces planifikimi ne te cilin mund te shqyrtohet i tere rrjeti dhe pa nje hirarki projektesh ne baze te rendesise se tyre strategjike dhe ekonomike, rezultatet e investimit nuk mund te jene te sigurta. Nepermjet identifikimit te rezultateve kyce, funksionimi i planifikimit strategjik mbeshet gjithashtu sakesimin e qellimeve te punimeve per sektorin rrugor, qellime qe mund te transformohen ne synime te metejshme per organiken rrugore.

12. **Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise** eshte miratuar qe ne vitin 1998 dhe ai percakton qarte autoritetin dhe pergjegjesine per gjithe veprimtarite e sektorit rrugor qe lidhet me perdorimin e rruges, ndertimin dhe mirembajtjen e saj. Ndryshimet ne Kodin Rrugor jane miratuar nga Parlamenti ne Shtator 2007, perfshire ketu edhe modifikimet e fundit. Keto ndryshime e kane perforcuar Kodin Rrugor, megjithe referencen e patur ne studimin e ANTP, ku legjislacioni Shqiptar nxjerr ne pah nje boshllek shqetesues ne lidhje me ligjet per shfrytezimin e tokes, duke perfshire regjistrimin dhe shpronesimin e prones per interesin publik, si dhe ne te njetjen kohe ka boshlleqe dhe ne ligjet per planifikimin urban. Aksesit ne rruge autorizohet ne kategorine nacionale edhe ne rastet kur ka konflikt me planet lokale te shfrytezimit te tokes. Si rrjedhoje ngushtimi i rruges dhe hyrje te pautorizuar ne autostrade, sic ndodh ne shume akse te Rrugeve Nacionale, shkaktojne bllokime shume serioze dhe rrezeqe ne sigurine rrugore. Nje shqyrtim i legjislacionit ekzistues eshte i nevojshem, per te permiresuar Kodin Rrugor per te hequr dobesite ekzistuese duke percaktuar kerkesa te reja per transformimin e sektorit rrugor.

13. Alokimet buxhetore per sektorin rrugor jane rritur se fundmi por sigurimi i nje fond te pershtatshem dhe te qendrueshem nga MTEF nuk eshte bere i mundur. **Mekanizmat financiar**e varen nga alokimet vjetore shteterore dhe perdoruesit rrugor nuk jane ne dijeni se gjithe tarifat e tyre, si tarifat e regjistrimit te makinave, taksat per karburantin dhe taksa te tjera, do te perdoren per riparimin e rrjetin rrugor, mirembajtjen dhe nderhyrje te tjera.

14. **Struktura e organikes dhe menaxhimit te DPRr** eshte projektuar per te kontraktuar kushtet e sherbimeve me themelore te planifikimit, projektimit, ndertimit dhe mirembajtjes duke bere ne te njetjen kohe ndarjen e roleve te pronarit dhe realizuesit te sherbimit sic ndodh ne gjithe organizatat me efektive. Kjo organik shteterore drejtohet nga ligji i Kodit Shqiptar te Punes qe eshte publikuar ne vitin 2003. Procedurat operuese te ketij kodi jane perpiluar ne menyre qe te ushtrojne kontroll permes shume proceseve duke verifikuar dhe ndjekur hap pas hapi veprimtarite e stafit. Megjithese keto procedura operuese perpilohen ne menyre te tille qe te elimininojne korrupsionin dhe te promovojne shfrytezimet e vete burimeve shteterore, te cilat konsiderohen si realizim i objektivave, e verteta qendron ne faktin se keto rregulla krijojne nje ambjent ne te cilin theksi bie me shume mbi evidentimin e pergjegjesive direkte per veprimet te kryera nga personeli. Kjo kulture ka si pasoj rezultate teper te ulta arritjesh dhe vonesa ne zbatim, rezultat i profesionalizmit jo efektiv te burimeve financiare dhe fizike.

15. **Sistemet e informacionit** nuk ekzistojne ne DPRr. Realisht kompjuterat ndodhen ne cdo zyre drejtuesi si ne Tirane (Qendra) ashtu edhe ne nivel Rajonal, por keta kompjutera perdoren vetem per sistemin "word", pergatitjen e letrave dhe posten elektronike. Drejtuesit nuk jane te lidhur ne rrjet per te shkëmbyer te dhena kompjuterike permes nje sistemi komunikimi brenda tyre. Megjithate SweRoad ka pergatitur nje program i cili perfshin te dhenat e Inventarit Rrugor ne kapacitetin GIS ne fund te viteve 1990, pergjegjesia per te aktualizuar kete program te dhenash i eshte lene DPRr. Te dhenat e trafikut per disa seksione rruge jane kaluar tashme ne kete program, por ky proces nuk eshte komplementuar akoma pasi nuk eshte aplikuar nje tipar baze dhe kusht inventarizimi per rrjetin. Sistemi per Menaxhimin e Pasurise Rrugore (RAMS) qe eshte pershtatur nga konsulenti i Asistences Teknike te MPPTT permban nje komponent per grumbullimin e te dhenave dhe detajeve te pasurive rrugore dhe kushtet e tyre. Megjithate nuk jane perfeksionuar aspak aplikimet qe mundesojne menaxhimin e informacionit per planifikimin strategjik, buxhetimin, menaxhimin financiar, menaxhimin e rrjetit rrugor, performancen monitoruese dhe burimet njerezore.

16. DPRr i mungon nje plane per **burimet njerezore** me qellim zhvillimin dhe mundesimin e nxitjes se performance me te larte te gjithe stafit profesional dhe teknik. Ka shume mungesa per staf te kualifikuar pasi:

- Nuk ka asnje program zyrtar trajnues qe te permiresoje aftesite menaxhuese dhe teknike;
- Ne ushtrimi funksionit nuk shoqerohet me trajnime pasi menaxhimi fokusohet me shume ne kerkesat burokratike dhe menaxhim krizash;
- Linjat e autoritetit nuk jane te qarta dhe personeli shpesh merr udhezime teper konfliktuale nga drejtuesit.

17. DPRr ka shume pak dokumentacion qe te udheheqe stafin pergjegjes ne angazhimin dhe menaxhimin e metejsheem te sektorit privat per te kryer gjithë shërbimet themelore si me poshte:

- TeR standarte per projektimin e rruges, ndertimi dhe mirembajtjen nuk jane percaktuar asnjehere qarte dhe TeR shpesh nuk permbushin nevojat e DPRr,

- Nuk eshte pergatitur ende nje dosje e vecante dhe e plote e specifikave te projektit per Shqiperine dhe keto specifika mund te ndryshojne ne varesi te kompanise qe eshte angazhuar per te pergatitur projektin (nje kompani angazhohet qe te pergatise nje set te plote te specifikimeve);

- Procedurat per supervizionin e kontraktoreve dhe konsulenteve te angazhuar nga DPRr nuk jane te standartizuara dhe te dokumentuara dhe shpesh rolet e Qeverise dhe te konsulentit ose supervizionit tejkalojne pergjegjesite e tyre ose futen ne konflikt me njera tjetren.

18. Alokimet e buxhetit per mirembajtjen e rruges dhe rindertimin e tyre jane bazuar ne alokimet te kaluara, pa asnje shtyqe per te identifikuar nevojat qe lidhen me nje politiken te qarte per mirembajtjes rrugore dhe zhvillimit te mundesimise dhe kushteve per mirembajtje te metejsheem.

III. KUADRI LIGJOR I REFORMES SE PROPOZUAR

6. Masat Perforcuese

19. Masat perforcuese qe jane propozuar i pershtaten nevojave qe gezojne gjashte kategorite e cituara ne vleresim te DPRr. Keto masa jane te domosdoshme per te mundesuar:

- Menaxhimin ambjental qe qarteson me mire detyren, qellimet dhe objektivat e sektorit dhe siguron nje ambjent operues ne te cilin ato mund te plotesohen;

- Strukturen organike dhe kuadrin ligjor te menaxhimit te burimeve njerezore qe siguron sa me qarte linjat e pergjegjesise, delegon autoritetin per vendim marrjen ne nivelet e caktuara, siguron paketat e duhura te kompensimit, terheq dhe e mban ne pune stafin me te kualifikuar dhe vlereson punen me te mire;

- Kuadrin e harmonizuar rregullator qe drejton dhe lehteson rolet per te gjitha palet duke parashtruar standartet dhe normat e qendrueshme, duke eliminuar pergjegjesite konfliktuale dhe mundeson autoritetin e nevojshem per te perforcuar me tej rregullat;

- Sistememi i informacionit qe sigurojne stafin ne nivelet e duhura me informacionin e nevojshem per te ndermarre sa me mire pergjegjesite e tyre;

- Mekanizmat qe promovojne financime sa me te qendrueshme dhe te pershtatshme per organiken rrugore;

- Standartet dhe procedurat qe synojne cilesine, te cilat duhet te dokumentohen ne manualet e zbatueshme si baze e metejsheem per trajnime dhe monitorimin e punes.

7. Organika

20. Autoriteti Rrugor Shqiptar i propozuar (ARSH) eshte nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuara Ligjore e regjistruar sipas Legjislacionin Shqiptar qe punon brenda fushes administrative te Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Ttelekomunikacionit (MPPTT). ARSH mund te ushtroje fuqi te plota shtetore ne fushen e menaxhimit rrugor sipas kushteve dhe hapesires se percaktuar me ligj duke specifikuar nevojat e klienteve te saj, qe jane perdoruesit rrugore ne Shqiperi. Per kryerjen e ketij funksioni ARSH mund te menaxhoje rrjetin dhe te marre vendime qe bazohen ne qellime profesionale te percaktuara **brenda kuadrit ligjor dhe politik te parashtruar nga MPPTT.**

21. ARSH mund te percaktohet si nje ent publik i pavarur, i cili mund te lejoje qe te menaxhohet ne linje me sektorin privat duke siguruar keshtu pavaresine e vet operuese dhe financiare si dhe te mundesoje rregullimin e pershtatshem te nivelit te pagesave. Modelet qe jane aplikuar ne Shqiperi, duke perfshire ketu Fondin e Zhvillimit Shqiptar, Portin e Duresit, dhe KESH, duhet te shqyrtohet dhe analizohet perpara pershtateshmerise se struktures se ARSH ne shërbim të nevojave të saj. Pritet qe stabilizimi i ketij enti mund te behet me propozimin e Keshillit te Ministrave dhe me pas me miratimin e ligjit perkates nga Parlamenti i Republikes se Shqiperise. Ligji mund te percaktoj statusin ligjor, projektimin, kufizimet, selin drejtuese, menaxhimin, strukturen, procedurat e operimit dhe administrimin e ARSH-s. Ne kete kuader mund te perfshihen pergjegjesite dhe marredheniet ndermjet gjithë paleve qe jane angazhuar ose mbeshtetin fushen e ndertimit, duke perfshire

shpronësimin e pjesës së verdhë të rrugës, mirëmbajtjen dhe operimin e rrjetit rrugor nacional. MPPTT duhet të kërkojë keshillim ligjor para se të vihet në jetë vendimi përfundimtar.

22. Paralelisht gjatë stabilizimit të ARSH-së MPPTT duhet të ndermarre një rishikim të gjithë legjislativitetit aktual që lidhet me sektorin në fjalë dhe të propozojë ndryshimet që kërkojnë, të rinovojë Kodin Rrugor dhe legjislativitetin përkatës për të eliminuar dobësitë ekzistuese dhe të vendosë kërkesa të reja.

23. Misioni i propozuar i ARSH-së është të kontribuojë për një standart më të mirë jetësor për gjithë personat në Shqipëri duke ndërtuar një rrjet nacional rrugor sa më i sigurtë e të përshtatshëm. Qëllimi gjithëpërfshirës i ARSH-së është që të sigurohet një rrjet rrugor në përputhje me Standartet e Bashkimit Europian, duke krijuar një linjë vitale për gjithë Rrjetin Trans-Europian dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetësorë. Në mbështetje të këtij misioni dhe qëllimi, ARSH duhet të përdorë në mënyrë sa më efektive dhe ekonomike burimet shtetërore për të prokuruar shërbimet e planifikuara, përmirësuar, mirëmbajtur dhe operuar në rrjetin rrugor.

24. ARSH mund të kërkojë mënyra që të përmirësohet siguria rrugore dhe shërbime për impaktet ambientale dhe sociale që lidhen me veprimtaritë e ndërtimit. Për të realizuar këto objektivë ARSH mund të përcaktojë njesitë përkatëse për ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe të krijojë njesitë e kontrollit të sigurisë dhe vlerësimet ambientale e sociale si një pjesë themelore e procesit të projektit.

25. ARSH mund të përdorë indikatorë siç janë plotësimi i kërkesave të përdoruesit rrugor, cilësia e rrjetit, koha e planifikuar për jetëgjatësinë e kontratës aktuale dhe koston si dhe statistiken e aksidentëve. ARSH mund të përgatisë një Raport Vjetor për të përmbledhur performancën dhe të theksojë aktivitetet e planifikuara dhe në vazhdim. Raporti Vjetor mund të paraqitet në Internet për tu parë direkt nga publiku. ARSH do të monitorojë indikatorët e performancës dhe do të ndermarri veprime korrigjuese në përmirësimin të performancës dhe nevojave të përdoruesve.

8. Struktura dhe Kuadri Ligjor i Menaxhimit të Burimeve Njerezore

26. ARSH mund të organizohet sipas shënave të një organike rrugore të suksesshme të karakterizuar si më poshtë:

- Një organike e ndërtuar që menaxhohet nga Bordi i Qeverisë dhe Aksionerëve të Sektorit Privat (Bordi Menaxhimit);
- Një staf me kariere profesionale, të vlerësuar në bazë të tarifave të mjaftueshme për të bërë atë sa më tërheqës, sa më të kualifikuar dhe të përzgjedhur nga një proces konkurrimi;
- Procedurat operuese që drejtohen drejt arritjeve të rezultateve themelore;
- Krijimin e mundësive, sipas niveleve të caktuara të organikës, për menaxhimin e informacionit që shërben për të përmirësuar produktivitetin dhe efikasitetin në performancë.


27. Bordi i Menaxhimit të ARSH-së mund të shpallë objektivat, të caktojë prioritetet për zbatimin e reformës, të miratojë programet vjetore të veprimeve dhe buxhetin korrespondues me qëllim arritjen e prioritetëve dhe vizionëve sipas planifikimeve strategjike të MPPTT. Ministri i MPPTT ose personi i caktuar nga ai mund të drejtojë Bordin e Menaxhimit (Kryetari). Drejtori Ekzekutiv (CEO) i ARSH mund të shërbejë si sekretariati i Bordit pa të drejtë votimi. Bordi mund të drejtojë takimet mujore dhe takimet e vecanta siç mund të jete planifikuar nga Kryetari. Anëtarë drejtues shtetërore të Bordit të Menaxhimit të ARSH mund të emërohen nga Ministri fushës që ata përfaqësojnë dhe të shërbejnë në rolin e tij. Secila nga Ministrinë e mëposhtme mund të përfaqësohet me një anëtar në Bord: (i) Ministri i Financës, (ii) Ministri i Brendshëm, (iii) Prefekturat, (iv) Ministri i Ekonomisë Tregtare dhe Energjisë.

28. Anëtarët drejtues aksioner të Bordit (Sektori Privat) mund të emërohen nga organizatat aksionere të miratuara nga Kryetari. Nuk është e rëndësishme të jenë anëtarë të organizatës që i emëron ata siç nuk duhet të jenë anëtarë të një organizate që ka marrëdhënie biznesi me ARSH. Ata mund të shërbejnë për një periudhë pesë vjeçare. Organizatat e mëposhtme mund të përfaqësohen nga një anëtar bordi si vijon: (i) Shoqata e Transportit Rrugor, (ii) Shoqata Sipërmarrëse ose organizata të tjera që përfaqësojnë përdoruesit rrugorë ose aksioner, (iii) Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, (iv) Shoqata e Përdoruesve Rrugorë Shqiptarë.

29. Bordi i Menaxhimit të ARA-s mund të përzgjedhë CEO-n. Bordi mund të miratojë kandidatët për Menaxherin e Përgjithshëm, Menaxherin Drejtorin Rajonal të përzgjedhur nga kandidatët e kualifikuar të propozuar nga CEO-s. Miratimi i Bordit mund të kërkojë zëvendësimin e

tyre. CEO mund te jete pergjegjes per menaxhimin e ARSH-s dhe te marre direktiva nga Bordi i Menaxhimit. Ai/ajo mund te percaktoje qellimin e detyrave per secilin nga pese njesite e menaxhimit nen mbikeqyrjen e tij/saj. Me poshte eshte treguar nje diagram e organikes se ARA-s.

Figura 3 Diagrami i organikes se propozuar per ARS



30. Oficeri i Marredhenieve me Publikun te ARSH-s mund te caktohet nga Ministri i MPPTT ne sherbim te tij. Ai/ajo do te jete perfaqesuesi kryesor i ARSH-s kunddrejt perdoruesve rrugore dhe publikun ne pergjithesi, gjithashtu Oficeri i Marredhenieve me Publikun do te caktohet ne zyren e presidentit per te kryer funksionet e tij.

31. Zyrtat rajonale ne rolin e tyre do te mbeshtesin njesine e Sherbimeve Rajonale ne prokurimin, menaxhimin dhe zbatimin e sherbimeve per projektet e rrugeve. Ata mund te angazhohen dhe mbeshtesin rrjetin rrugor me gjithe detajet e tij dhe mirembajtjen e gjithe inventareve si dhe te kryejne funksionin e Perfaqesuesit te Punedhenesit per kontratat e mirembajtjes rrugore.

32. Veprimtarite kryesore te cdo njesie te ARSH-s tregohen ne Shtojcen II. Shtojca II rendit gjithe kategorite e stafit te propozuar per ARSH-n. Struktura dhe kategorite e stafit duhet te shqyrtohen nga Njesia e Zbatimit te Reformes (RIT) para se te kryhet rekrutimi i ketij stafi. Rekrutimi i stafit do kryhet ne bazen e arsimit, experiences dhe referencave. Punonjesit aktuale mund te konsiderohen per te gjitha pozicionet ekzistuese. Nese provohet se ata jane te pershtatshem per te permbushur gjithe kerketat e pozicionit ne fjale, atahere atyre do i jepet avantazh ne procesin e perzgjedhjes. Vendimi perfundimtar do jepet nga CEO dhe miratohet me pas nga Bordi i Menaxhimit. Procesi i vleresimit per stafin nuk perfshin sherbime si: sigurimi i ndertes, pastrimi, pajisjet dhe mirembajtja e ndertes pasi keto sherbime mund te sigurohen nga burime te tjera.

33. Vleresimi i stafit qe tregohet ne Shtojcen III eshte permbledhur ne Tabelen 1 si meposhte. Ajo tregon nje renie te lehte, me pak se 60% te stafit profesional aktual. Zvogelimi i stafit mund te preke fillimisht personelin rajonal duke ulur numrin e tyre nga 12 deri ne 3 drejtori, sic u nenvizua ne Seminarin e Reformes Institucionale qe u mbajt ne Tirane me date 21 Shtator, 2007. Sic tregohet ne Figuren 3 me poshte, vendimi perfundimtar per numrin e rajoneve, do behet gjate Fazes I te zbatimit te plan veprimit, dhe bazuar ne vendimin perfundimtar ne lidhje me numrin e rajoneve, vleresimi i stafit mund te rishqyrtohet. Megjithate jane propozuar edhe pozicione te reja per stafin drejtues ne zyrtat qendrore, ku stafi aktual mund te zvogelohet afersisht deri ne 33%. Pozicionet e reja te propozuara jane:

- Krijimin e nje Njesie shume profesionale per Sistemin e Informacionit, qe te stabilizohen dhe mirembahen sistemet moderne te informacionit – nje kerkese themelore kjo, per permiresimin e

performances se stafit;

- Krijimin e nje Njesie per Sigurine Rrugore, si nevojte urgjente kjo, per permiresimin e sigurise rrugore ne Shqiperi, aktualisht si nje nga vendeve me tregues shume te ulet te sigurise rrugore ne rajon;

- Krijimin e nje Njesie Sociale dhe Ambjentale, per te theksuar posacerisht keto funksione ne lidhje me Standartet e miratuara te Bashkimit European;

Tabela 1 Nivelet e Stafit

	AUTORIZIMI AKTUAL	ARA E PROPOZUAR
ZYRAT QENDRORE	106	74
RAJONET	161	39
TOTALI	267	113

34. Sic tregohet ne seksionet e meparshme, ristrukturimi pa ndryshimin e ambjentit operues, nuk mund te promovojte performance shume efikase. Per te mundesuar nje kultur performance sa me te larte, menyra e menaxhimit te burimeve njerezore duhet te plotesoj kerkesat e meposhtme:

- Kategori te kenaqshme pagese, te mjaftueshme per terheqjen e stafit sa me te kualifikuar;
- Staf me eksperience shume profesionale, te cilet i dedikohen teresisht punes dhe mbajne rendimentin e tyre ne rezultate shume te kenaqshme;

- Nje ambjent operues qe mundeson teknologjine, sherbimet dhe makinerite e kerkuara per rritjen e produktivitetit ne pune;

- Nje kulture pune me qellime shume te qarta per detyrat qe do kryhet, e kanalizuar mire, duke shperblyer stafin qe jep rezultate dhe zevendesuar stafin pa rezultate ne punen e tij.

35. Legjislacioni qe percakton mire nevojat e ARSH-s, duhet te siguroje qe organika e krijuar te kete aftesine per te percaktuar mire paketat e pageses, per te terhequr ne pune dhe ruajtur te sigurte stafin e kualifikuar. Nese nuk eshte e mundur te percaktohen kategorite e pagesave, mund te jepen shperblime, ne formen e bonuseve ose pagesave shtese per te nxitur me tej stafin ne pune. Gjithashtu duhet te mundesohen mekanizma per mbrojtjen e stafit qe punon me efikasite, duke dhene paketa shperblyese per keta te fundit dhe krijuar ne kete menyre ambjentin e duhur per kete kategori punonjesis. Nga ana tjeter duhet te eliminohet influenca e stafit te pakualifikuar ose stafit jo efikas per tu caktuar serish ne pozicionet e mevonshme te ARSH-s.

36. Sherbimet e tanishme te zyrove per stafin e DPRr dhe PIT jane te kufizuara, duke I kerkuar stafit profesional ndarrjen e zyres, pamundesi e rrjetit te internet dhe pothuajse me mungese te theksuar te informacionit, dhe kufizim te vizitave ne kantier per shkatte te mungeses se mjeteve transportuese. Nese Qeveria deshton ne mundesimin e ketyre sherbimeve operuese per te eliminuar gjithte keto mangesi ne nje reforme te re institucionale, atehere nuk do te behet I mundur realizimi i gjithte rezultateve te shprehura me lart.

37. ARSH mund te percaktojte nje Sistem per Menaxhimin e Burimeve Njerezore (HRMS), qe mbeshtet punonjesit e ARSH-s dhe percakton kushtet per te terhequr e pasur sa me shume stafi te kualifikuar: HRMS do te permbaje sa me poshte:

- Marredheniet dhe funksionet te detajuara si dhe pergjegjesite e drejtuesve dhe njesite rajonale dhe marredheniet me organizatat e tjera te sektorit;

- Pershkrimet e pozicionit dhe perkufizimin e aftesive te kerkuara qe do kryeje keto funksione ne strukturen e perkufizuar te ARSH-s, politikat dhe klasifikimin;

- Nje vleresim per menyren e rezultatit te punes nga punonjesit, te bazuar ne punen vjetore, per te arritur qellimet e vendosura dhe inkurajon inkuadrimin e aftesive te vazhdueshme dhe punen e efikase;

- Pergatitjen e nje plani per zhvillimin e burimeve njerezore qe perfshin nevojten per trajnim, dhe shperndarjen e mekanizmave trajnues, per ta pajisur stafin me gjithte aftesiste menaxhuese qe kerkohen per te organizuar nje pune teper moderne si dhe rifreskimin dhe permiresimin e aftesive te vecanta qe nevojiten per kryerjen e detyrave te kerkuara. Ky plan zhvillimi mund te jete thelbi i nje ecurie te metejshme per burimet njerezore dhe per politiken gjithperfshirese te stafit.

38. Vleresimet sipas kushteve te trajnimit do te percaktonin gjithashtu nevojat dhe mekanizmat e menyres se trajnimit per punonjesit e sektorit privat qe kane marredhenie pune me ARSH-ne dhe stafin e tyre. ARSH mund te perfshije trajnimin e stafit gjate procesit te parakualifikimit dhe perzgjedhjes.

39. Propozimet e treguara ne paragrafet e meparshem ofrojne gjykimin e konsulentit per nje strukture sa me efektive ne kuadrin e menaxhimit te ARSH-se. Shume prej ketyre detajeve ne lidhje me nevojen e propozuar duhen analizuar dhe mundesisht modifikuar gjate periudhes se zbatimit. Tabela 2 ne faqen tjeter identifikon disa nga ceshtjet qe kane lidhje me rekomandimet dhe rendit gjithë zgjidhjet alternative. Keto ceshtje duhet te zgjidhen nga MPPTT ne fazat e para te zbatimit te reformes se DPRr. Nje rekomandim i nevojshem per zgjidhjen e ketyre ceshtjeve eshte dhene ne Seksionin IV te ketij raporti.

Tabela 2. Çeshtje që kërkojnë zgjidhje në fazat e para të transformimit të DPRr

Perberesi	Problematike	Mundesite
Bordi i Menaxhimit	DFR propozon qe shoqata e sipermarresve te emeroje nje person per bordin e drejtoresve. Dy shqetesime duhet te merren parasysh: (i) krijimi i nje konflikt interesi; (ii) perzgjedhja e shoqates, pasi ka me shume se nje shoqate qe perfaqeson sipermarresit. Ne raste se merret nje vendim <u>per te mos</u> patur nje person te emeruar nga sipermarresit ne Bord, nje e treta e bordit nuk duhet te jete me perfaqesi qeveritare.	1. Shoqata e sipermarresve mund te emeroje nje person te kualifikuar qe nuk ka lidhje me asnje sipermarresit. Ky person nuk do zevendesohet derisa te perfundoje kontrata e tij/saj ne bord ose derisa maxhoriteti i anetareve te bordit te votoje per zevendesimin e tij ne nje takim me bordin, te hapur per publikun. (Mundesia e prezantuar ne Raportin Perfundimtar) 2. Te perzgjidhet nje grup alternativ ne rolin e nje institucioni edukues ose organike tjeter qe perfaqeson perdoruesit rrugor ose aksioneret.
Presidenti i ARSH-s	DFR propozon emerimin e Presidentit nga Ministri si e drejte e rezervuar e tij. Eshte menduar qe roli i Presidentit te jete fillimisht per marredheniet me publikun bashke me CEO-n, pergjegjes per menaxhimin e operimeve. Ceshtjet qe duhen trajtuar jane: (i) nderhyrja e Presidentit ne menaxhimin e ARSH-s duke konpromentuar produktivitetin e organikes, (ii) nese nuk ka asnje punonjes me influence politike ne ARSH-n , atehere do kete nxitje te forta politike per qeverite e ardhshme te zevendesoj CEO (ne munges te vendit te Presidentit) me shume per arsye politike se sa profesionale.	1. Te eliminoje pozicionin e Presidentit me I kaluar ketij te fundit kompetencat e Presidentit 2. Te ruaje pozicionin e Presidentit. 3. Te eliminoje pozicionin e Presidentit por te krijojte nje pozicion nen supervizionin e CEO-s per nje Officer Marredheniesh me Publikun, pozicion qe do zihet nga nje person i emeruar nga Ministri i MPPTT. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Perfundimtar)
Menaxheri Pergjithshem per Projektet e financuara nga jashte	DFR propozon pozicionin e Menaxherit te Pergjithshem per Projektet e Financuara nga jashte. Ky rekomandim pasqyron linjen aktuale nese Zevendes Menaxheri i Pergjithshem i PIT e permbush kete rol per menaxhimin e gjithë veprimtarive qe lidhen me prokurimin, shpronesimin e tokes, supervizionin dhe marrjen ne dorezim te shume projekteve qe financohen nga jashte dhe disa nga projektet qe financohen me fonde lokale. Eshte e kuptueshme qe ka disa pika per te ardhmen, kur projektet e financuara nga jashte nuk do te perfaqesojne me nje pjese themelore te ngarkeses se punes se ARSH-s, dhe kjo njesi mund te eliminohet. Komenetet ne DFR tregojne nje influence dominuese per gjithë pergjegjesite paralele mes njesive te menaxhimit dhe nje strukture te plote organike me shtate menaxhere te pergjithshem qe i raportojne CEO-s.	1. Te mirembaje njesine e projekteve me financiam nga jashte sic propozohet nga DFR me funksionet paralele brenda kesaj njesie qe pasqyrojne ne vecanti ekspertizen e specifike qe kerkohet per te permbushur kerketat e menaxhimit te projektit dhe prokurimit per IFI te ndryshme. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Perfundimtar) 2. Mundesine per te krijuar nje njesi brenda njesise se sherbimeve rajonale pergjegjese per projektet e financuara nga jashte.

Perberesi	Problematiche	Mundesite
Njesite e BNj dhe IT	DFR propozon qe Teknologjia e Informacionit dhe funksionet e Burimeve Njerezore te jene ne perputhje me statusin direkt te Menaxherit te Pergjithshem duke raportuar direkt te CEO. Kjo eshte ne nje linje me praktiken aktuale ne shume organizma te sektorit privat duke njohur kontributin ne menaxhimin sa me te mire te burimeve njerezore dhe sistemeve moderne te informacionit. Komentet per DFR njohin dhe mbeshtetin mirembajtjen e propozuar te BNj dhe IT, megjithate ata sugjerojne qe keto funksione duhet te pershtaten brenda Njesie se propozuar Administrative dhe Sherbimeve Financiare.	1. Te rruaj pozicionin e Teknologjine dhe Informacionit dhe Menaxherin e Burimeve Njerezore, pozicione qe jane propozuar ne DFR. Kjo do te beje te mundur perzgjedhjen e personave te kualifikuar ne drejtimin e ketyre fushave kritike per transformimin e suksesshem transformimin organik. 2. Te akomodoje IT dhe BNj brenda nje Nesie per Sherbimet Administrative dhe Financiare per te perzgjedhur personat qe jane te vetedijshem per rendesine e ketyre njesive dhe mbeshtetin nivelet e ulta, mundesishet me pak te kualifikuara, menaxheret qe drejtojne departamentet brenda njesive. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Perfundimtar)
Numri i rajoneve	DFR propozon qe linja organike e tanishme prej 12 Rajoneve duhet te ruhet, duke siguruar argumentet per mbeshtetjen e ketij pozicioni. Ajo propozon qe vendimi perfundimtar te kryhet ne Fazen I te Plan Veprimit. Nga rezultati i pjesemarresve ne seminarin e Shtatorit 2007, jane propozuar caktimi i 3 rajoneve, ne linje kjo me rekomandimet e studimit te ANTP. Komentet per DFR jane mbeshtetur ne alternimin e vendimit per numrin e rajoneve, derisa te ndermerren vleresime te metejshme per te klasifikuar stafin e kualifikuar ne nivel rajonal dhe rolin e caktuar te Rajonave.	1. Te sigurohet nje linje me 12 zyra rajonale. 2. Te alternoje vendimin per numrin e caktuar te rajoneve ne vartesi te analizave te metejshme. 3. Te procedoje ne premisen qe numrin i rajoneve te zvogelohet deri ne tre por te beje prezantimin e analizave te metejshme para se te shpaloset ne vendimin e percakimit te sakte te rajoneve. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Perfundimtar)
Roli i Rajoneve	DFR propozon qe Rajoneve ti kalohet fillimisht pergjegjesia per kryerjen e rolit te Perfaqesuesit te Punedhenesit per kontratat e Mirembajtjes dhe konsiderimin e dhene per delegimin e pergjegjesive per prokurimin e sherbimeve te kontratave me vlere te vogla te ndertimit dhe mirembajtjes se projekteteve ne rajon. Vendimi mbi te cilin, nese ndonje kontrate mund te prokurohet ne nivle rajonal mund te merret nga Njesia e Sherbimeve Rajonale ne Tirane. Komentet per RPD tregojne qe kjo ide mund te mos jete e keshillueshme ne kete kohe per mungesen e ekspertizes se duhur ne nivel rajonal.	1. Te ruhet nje mundesi per te bere prokurim ne nivel rajonal. 2. Te sjelle gjithte prokurimet ne nivel qendror por ende te ruaje rolin ne rajone te Perfaqesuesit te Punedhenesit per mirembajtjen dhe prokurimin e disa projekteve te vogla per ndertim. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Final) 3. Te terhiqen te gjitha prokurimet dhe te sherbeje ne rolin e punedhenesit ne nivel qendror. Shenim: Ne te tera Mundesite mbikeqyrja te kryhet nga konsulenti.
Bordi Rajonal	DFR propozon stabilizimin e nje Bordi Rajonal. Ideja eshte mundesimi i nje shtylle per perdoruesit rrugore ne nivel rajonal per te patur akses informacioni ne lidhje me veprimtarite e planifikuara per rajonin dhe nje menyre me qellim shprehjen e prioritetet rajonale qe lidhen me ARSH-n.	1. Te stabilizojte Bordin rajonal dhe monitoroje interesin ne rajone per te siguruar rezultate te mira per perdoruesin rrugor dhe te dhena per planifikimin dhe menaxhimin e projektit ne nivel rajonal.

Perberesi	Problematiche	Mundesite
	Ky veprim eshte marre ne perpgjigjje te mendimeve qe jane shprehur nga vete rajonet qe masin zbatueshmerine e punimeve nepermjet vendimeve ne nivel qendror qe jo gjithmone shpalosin prioritetet rajonale. Komente per DRF kane ngritur dyshime rreth nevojës dhe rolit te propozuar per Bordin Rajonal.	2. Te vendosi per mos caktimin e Bordin Rajonal dhe te kerkoje te dhena nga perdoruesit rrugore ne nivel rajonal nga forumet e tjera sic jane seancat degjimore publike ose grupet e fokusimit. Kjo metode eshte shume e perhapur ne agjensite rrugore per te arritur rezultatin e pritshem per perdoruesit rrugore. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Final)
Financime te sakta dhe te qendrueshme	DFR liston lejueshmerine per financime te qendrueshme dhe te pershtatshme si karakteristikat me te rendesishme te organikes moderne te rrugeve. Raporti propozon se duhet te miratohet nje marreveshje sherbimesh ndermjet Qeverise dhe ARSH-se me angazhimin serioz per te mundesuarit nje elementi kyc per financime te qendrueshme. Modeli i perdorur eshte pergatitur nga BERZh dhe eshte zbatuar me shume sukses ne Azerbajhan. Shume vende kane kanalizuar stabilizimin e nje fondi rrugor si nje menyre per te siguruar financime te sakta e te qendrueshme. Rezultatet jane perzier me financime te sakta qe jane zbatuar ne disa vende por qe kane deshtuar ne shperndarjen e rezultateve te pritshme per shkak te korrupsionit dhe mos menaxhimit. Komente per DFR sugjerojne qe Fondi Rrugor te shqyrtohet nga MPPTT.	1. Te mirebesohet ne shperndarjen e sakte te fondeve shteterore duke u bazuar ne angazhimet e Marreveshjeve te Sherbimeve. (Mundesi e prezantuar ne Raportin Final) 2. Te merret miratimi nga Qeveria per te stabilizuar nje fond vecanerisht per rruget. Kjo do kerkoje miratimin e MF.

9. Kuadri Rregullator

40. MPPTT, ne mbeshtetje te ARSH, duhet te angazhoje ne pune ekspertize ligjore vendase per te qene ne brendesi te permbledhjes ne teresi te gjithë kuadrit qeverises rregullator te veprimtarive ne sektorin rrugor. Fushat me interes te vecante jane prokurimi, regjistrimi I tokes dhe shpronësimi, aksesit ne rrjetin rrugor, dimensionit I automjetit dhe specifikimet e peshes, siguria rrugore dhe mbrojtja ambjentale. Kjo permbledhje I adresohet nivelit ne te cilen fuqizohet organika dhe entet e tjera qeverisese per te perforcuar legjislacionin aktual dhe ndryshimet e tjera qe mbështesin me mire ligjin. Ekspertët mund te pergatisin nje raport qe permbledh dobesite ne legjislacionin ekzistues dhe zbatuesmerine e rregulloreve dhe qellimin e legjislacionit te permiresuar per tu marre parasysh nga MPPTT dhe Keshilli i Ministrave.

41. Per gjithë masat e ndermarra nga Keshilli i Ministrave, ekspertët mund te parashikojne legjislacionin perkates ose axhenden e duhur qe te modifikohet legjislacioni aktual dhe te nise zbatimin i rregulloreve. MPPTT dhe ARSH nepermjet stafit juridik mund te monitoroje ecurine e fuqizimit te metejshem te legjislacionit te ri.

10. Sistemet e Informacionit

42. ARSH mund te instaloje nje program te kompletuar kompjuterizimi per rritjen e performances nepermjet:

- Rekrutimit te nje person te kualifikuar per pozicionin e Menaxherit te Sistemeve te Informacionit – ky person duhet te kete nje rol themelor ne njesine e menaxhimit dhe duhet te kete eksperience ne zbatimin dhe sistemet operuese te informacionit ose organikat e sektorit privat ne Shqiperi ose ne vendet e tjera;

- Komunikimit per te ndergjegjesuar menaxhimin drejtues, perfshirjen, mirekuptimin dhe teknologjine e informacionit nepermjet takimeve dhe seminareve;

- Investimi ne teknologjine e informacionit eshte ne perputhje me vleren e saj ne arritjen e objektivave organike te ARSH;

- Stabilizimi i marreveshjes kontraktuale me kompani lokale qe mundeson mbështetje ne teknologjine e informacionit duke perfshire mirembajtjen e projektimit te rrjetit dhe sistemet e komunikacionit;

- Trajnime ne aftësite kompjuterike sic jane perdorimi i formateve te njohura dhe procesimi i programit word.

43. ARSH mund te rifreskoje sistemet e informacionit per te kanalizuar shpenzimet ne hapjen e gjurmës rrugore, kryerjen e projekteve, kondicionet e rrjetit rrugor dhe synimin e perdoruesit rrugor per te pajisur menaxheret me informacionin e kerkuar per performanc sa me efektive.

11. Fonde te Aktuara dhe te Qendrueshme

44. MPPTT ne gjithë rolin e saj planifikues e strategjik duhet te percaktojë mire politiken e mirembajtjes rrugore, dhe te bashkepusoje shume ngushte me Qeverine dhe drejtuesit e sektorit rrugor, te krijojë nje mirekuptim per nevojen e angazhimit serioz ne pune, duke patur financime te siguruar per sektorin rrugor. ARSH duhet te perforcoje planifikimin e saj per te identifikuar dhe vendosur prioritet ne investimet rutine e periodike si edhe te rrisë kapacitetin e rrjetit. ARSH duhet te angazhoje konsulente qe te pergatisin Planin e Mundësive Strategjike (SOP) qe te identifikohet shperndarja e mundësive ne rrjet per MTEF bazuar ne kuadrin strategjik te percaktuar ne studimin e ANTP. SOP mund te percaktojë sasine per kerkese buxhetore per mirembajtje dhe te demonstroje impaktin sipas te cilit kalon financimi I mirembajtjes rutine dhe periodik ne lidhje me kostot e perdoruesve rrugore dhe humbjes se vleres se pasurise rrugore. SOP duhet te jete justifikimi numer nje per kerkese buxhetore dhe duhet te permiresohet cdo vit. ARSH duhet te eksploroje alternativat e mundësive financuese sic jane taksat dhe tarifat per automjetet e transportit per te balancuar alokimet shteterore.

45. Strategjia e Transportit e pergatitur nga MPPTT ne Qershor 2007 percakton qellimet per investim ne sektorin rrugor te treguar ne Tabelen 2 me poshte:

Tabela 2 Qellimi i Strategjise se Transportit per Alokimet Buxhetare

KATEGORIA E BUXHETIT	INVESTIMET NE LEKE/MILLION					
	2008	2009	2010	2011	2012	2013
INVESTIMET BUXHETORE	14,697	17,983	24,491	26,940	29,360	32,300
INVESTIMET E HUAJA	19,179	22,334	19,963	21,960	23,940	26,300
SHPENZIMET AKTUALE	1,450	1,969	2,955	3,850	4,700	5,800
NE TOTAL	37,334	44,295	49,419	54,761	60,012	66,413

46. Ne total alokimi buxhetor i propozuar, nese e shohim ne tebele ka nje rrenie nga viti 2007 deri ne 2008, qe perfaqeson nje rritje mesatare vjetore prej 9% gjate gjashte viteve te periudhes se parashikuar. Kjo eshte konsideruar si nje permbledhje per te percaktuar nivelin e financimit per sektorin. Financimi per mirembajtjen rutine dhe periodike eshte perfshire ne kategorine e Shpenzimeve Rrjedhese. Rekomandohet se sasia e alokuar qe eshte rritur behet per te mbeshtetur financimet e caktuara per mirembajtjen. Llogaritjet paraprake tregojne se per buxhetin e 2008 ka nje fond prej 2 milione lekesh per mirembajtjen periodike dhe 1.6 milione per mirembajtjen rutine. Kjo llogaritje merr parasysh riklasifikimin¹ e rrjetit per te perfshire dhe 1,500 kilometra shtese. Nese riklasifikimi nuk eshte bere ende, me buxhetin e mirembajtjes mund te kete rrenie ne baze te analizave. SOP e propozuar dhe RAMS do siguroje me teper llogaritje te sakta te kerkesave te financimit per mirembajtjen rutine dhe periodike.

47. Per te patur financime te sakta dhe te qendrueshme per sektorin e ARSH, duhet te nenshkruhet nje marreveshje me qeverine duke i permbledhur zyrtarisht, ne nje angazhim sa me te sakte financues per sektorin e rrugëve.

12. Sherbimet Themelore

48. Ne nje kohe shume te shkurter ARSH mund te ndermarre hapa qe permiresojne eficiencen dhe cilesine e ndertimeve rrugore dhe ngritjen e nivelit te procesit planifikues, duke permiresuar cilesine e projektit, duke bere ekspedita per shpronesimet dhe perforcimin e sigurimit te cilesise.

49. Per te permiresuar cilesine e projektimit te ARSH, mund te kerkohen perpjekje ne shume menyra, qe te pergatiten standartet e projektimit per Shqiperine, te tilla standarte qe jane ne linje me Bashkimin Europian dhe te dokumentohen procedurat e miratuara te projektimit ne nje udhezues projektsh. Pritet qe me tu bere operuese skema e ARSH, me gjithë standartet e saj te percaktuara sakte, duhet te jete pergatitur dhe miratuar me pare nga MPPTT, udhezuesi i projekteve. Programi per ndertimin e kapaciteteve te burimeve njerezore mund te projektohet per te mbeshtetur zbatimin e standarteve dhe procedurat e projektimit qe jane ne perputhje me keto iniciativa.

50. Per teurvejuar shpronesimet ARSH duhet te kerkohen perforcime ne kuadrin rregullator per kete veprimtari dhe te angazhohen kompani te specializuara per shpronesimet.

51. Per te perforcuar cilesine e ARSH mund te pergatitet nje udhezues per sigurine e cilesise qe percakton procesin e QA per kontraktoret dhe konsulentet e supervizionit dhe qe sherben si baze per trajnim dhe fuqizim. Keto veprimtari mund te permiresojne cilesine e punimeve te perfunduara, te ulin numrin e ndryshimeve ne kontrate, te ulin vonesat ne ndertim dhe te cojne ne kosto sa me te ulta ndertimi, keshtu qe projektet mund te perfundohen duke patur financime te disponueshme.

52. Ne linje paralele per te fuqizuar cilesine e ndertimit ARSH duhet te kerkoje qe te permiresojne cilesine e mirembajtjes se rruges me ane te rritjes se alokimeve per mirembajtjen e rrugëve, duke menjanuar shfrytezimin e forcave te veta per mirembajtje dhe shperndarjen e kontraktimit te mirembajtjes. Kjo mbetet ne linje me iniciativat qe tashme jane vene ne rruge e siper per te zvogeluar numrin e punonjesve te mirembajtjes se DPRR qe eshte afersisht 300 dhe kontraktimin e nje testi pilot per mirembajtjen ne dy drejtorite rajonale te DPRR.² Keto iniciativa priten te kontribojne per te permiresuar cilesine e rrjetit dhe per te ulur sa me shume koston operuese.

53. Rekomandimet e nenvizuara me lart mund te mbeshtesin vendim marrjen dhe te sigurojne

¹ Eshte bere nje studim riklasifikimi si nje perberes i Projekteve te Bankes Boteroreper financimin te Rrugëve.

² Iniciativat per kontratat e mirembajtjes kane nisur me financimin e Bankes Boterore ne vitin 2005 sipas Projektit the Mirembajtjes se Rrugëve qe ka kapur rajonet nga Kukesi dhe Tirane sipas nje komponenti te projekteve the transportit te Bankes Boterore.

kushtet e nevojshme per aktivitet sa me efikas duke perfshire:

- Funksionim buxhetor dhe planifikim sa me te pergatitur;
- Procese me te permiresuara per projektimin e rrugeve dhe shpronesimin;
- Cilesi dhe pune me e mire ne ndertimine e rruges;
- Rendesi e vecante ne mirembajtjen e rrugeve dhe menaxhimin e aseteve dhe sa me shume shperndarje efektive te sherbimeve te mirembajtjes;
- Sistemet per te gjurmuar punimet dhe te ruhen shpenzimet.

13. Mekanizmat e Shperndarjes

54. ARA duhet te organizoje nje njesi te perqendruar ne kontraktme, qe mbeshtetet nga zyrat rajonale. Veprimtarite kryesore te ARSH mund te nisin me procesin e tenderimit duke perfshire pergatitjen e Termave te References (TOR), publikimin, vleresimi, perzgjedhja, njoftimi per procedimin dhe monitorimin e punes se paleve te kontraktuara. Pergjegjesi te tjera qe kane te bejne me kontraten jane:

- Ne rolin e perfaqesuesit te punedhensesit per kontratat e ndertimit dhe te mirembajtjes;
- Nuk kerkohet mbikqyrja e projekteve qe jane angazhuar kompanite e supervizionit ose individe the tjere – kjo fillimisht do te ndiqet per sherbimet e projekteve dhe asistencen teknike por qe mund te perfshije kontrata e vogla the ndertimit dhe kontratat emergjente te mirembajtjes;
- Menaxhimi i marrjes ne dorezim kur jane perfunduar kontratat e ndertimit.

55. Kontraktoret, konsulentet dhe kompanite e tjera te specializuara mund te angazhohen ne procedurat tenderuese lokale qe te kryejne the gjitha sherbimet per te cilat ato jane kualifikuar. Kjo perfshin pothuajse the gjitha sherbimet e prokuruar ne nivel rajonal dhe pjesen me te madhe te sherbimeve qe investohen nga buxheti. Projektet me te medha kerkojne me shume kapacitet financiar ose ekspertize the kualifikuar ose pajisje qe do tenderohen me procedurat nderkombetare tenderuese.

56. TeR, vecanerisht ato per projektimin dhe supervizionin e ndertimit do te shqyrtohen dhe perforcohen ne menyre qe siguresit e sherbimeve te kuptojne dhe te plotesojne anen ligjore per te gjitha veprimtarite e kerkuara per arritje e cilesise. Udhezuesit e projektimit dhe supervizionit te ndertimit per ARSH do te referohen mbi parapergatitjen e modelit te TeR per projektet tip.

IV. PLAN VEPRIMI I REFORMES INSTITUCIONALE


14. Plan Veprimi i Reformes Institucionale

57. Ne shume raste mungesa e perpjekjeve per reforme institucionale ndodh gjate tranzicionit, qe nis nga zhvillimi i strategjise deri ne fazen e zbatimit. Per tu siguruar qe kjo te mos ndodhe, eshte pergatitur nje plan veprimi i detajuar qe rendit pjesen me te madhe te veprimtarive dhe faktoret e suksesit qe nevojiten per the menaxhuar zbatimin e procesit. Per te zbatuar kete plan duhet te caktohet nje Njesi e disiplinuar per Zbatimin e Reformes (RIT) me nivel shume te larte per mirekuptimin e te gjithë rekomandimeve. RIT mund te punoje shume ngushte me konsulentet e asistences teknike qe te shtyje perpara cdo hap te planit. Gjate Fazes I, RIT mund ti raportojte direkt Njesise se Menaxhimit qe kryesohet nga Ministri i MPPTT me perfaqesimin me te larte te agjensive me te rendesishme per ta bere kete transformim sa me te suksesshem. Pasi te caktohet Bordi i Menaxhimit te ARSH-se, RIT do raportojte Bordin.

58. Plani i Veprimit per Refomen Institucionale (IRAP) eshte nja plan me dy faze qe ndertohet ne baze te iniciativave strategjike qe jane ndermarre ne veprimet e metejshme qe do kerkohen per te formuar ARSH-ne dhe funksionimin e saj duke e pajisur me gjithë sherbimet e nevojshme per ta nisur ARSH-ne ne Dhjetor 2009. Plan veprimi nderthur nje teresi vendimesh per reformen institucionale duke bere te ditur se ndryshimet e thjeshta te strukture organike nuk do krijojne nje organizim te suksesshem. Plani mbeshtet nje ndryshim shume themelor per bashkepunim si sa me poshte: (i) fokusohet ne permbushjen me efikasitet te detyrave, (ii) I jep stafit mjetet dhe strukturen e kompensimit per nivele sa me the larta performance ne pune, (iii) percakton qellimet e verteta, (iv) rivlereson e shperblen performancen e larte, dhe (v) parashikon shkaqet per zevendesimin e atyre qe nuk prodhojne. Ky plan veprim perfaqeson nje menyre qe con me perpara sektorin e rrugeve ne Shqiperi.

59. Figura 5 me poshte eshte nje perfaqesim skematik i plan veprimit. Figura 6, ne fund te ketij seksioni eshte nje tabelë me programin e plan zbatimit qe tregon fillimin dhe fundin per cdo veprimtari te pershkruar me poshte. Sic tregon tabela shume veprimtari do ndermerren paralelisht me me njera tjetren ne rruge e sipër ne cdo kohe.

Figure 4 Plan Veprimi i Reformes Institucionale



6

60. Tashme ka nisur procesi i transformimit

Studimi i ANTP percakton strategjine dhe drejtimin per reformen e sektorit si edhe karakteristikat strukture ne pergjithesi te organikes se re dhe te miratuar nga Parlamenti. Staf i MPPTT dhe DPRr jane perfshire nga pjesemarrja e percaktuar ne seminare dhe intervista ne te cilat perforcohet dhe dobesohet DPRr dhe propozimet per perforcimin insitucional jane prezantuar dhe jane

diskutuar tashme. MPPTT ka ndermarre hapa te tjera paraprake duke reduktuar numrin e punonjesve te mirembajtjes ne rajonet dhe stabilizimin e Institutit te Transportit. Mund te behej me shume edhe me pare se te vendoset per ARSH-ne, duke perfshire perhapjen sa me shume te kontraktimit te mirembajtjes dhe uljen me tej te numrit te punonjesve ne kantier.

61. Pritet qe MPPTT te nxise Keshillin e Ministrave te miratoje planin e ristrukturimit te ARSH-se ne fillim te Janarit 2008. Kjo perfshin marreveshjen per te stabilizuar ARSH-n, karakteristikat e saj strukturore dhe operuese, bazen ligjore mbeshetese dhe afatin e pergjithshem te funksionimit te ARSH.

62. Me te proceduar me transformimin dhe detajet e plan veprimit te reformes duhet te rishikohen vazhdimisht dhe rregullohen mire rezultatet e reformes institucionale pasi vetem nese ato rishikohen vazhdimisht mund te arrihet modeli i nje strukture moderne dhe efektive per organiken e sektorit rrugor duke u kryer keshtu misioni i propozuar ne kontribuimin e nje standarti jetese me te mire per gjith njerezit qe jetojne ne Shqiperi, me krijimin e nje rrjet rrugor shume te zhvilluar. Fillimisht RIT mund te shqyrtoje kete Plan Veprim, dhe te rekomandoje rregullime per Njesine e Menaxhimit bazuar ne ecurine e perditeshme te punes dhe eksperincen ne Shqiperi. Nje veprimtari ne vazhdimesi e RIT mund te mbaje ne linje planin aktual dhe te identifikojte modifikimet ose shtesat qe ruajne kete status dhe arrijne qellimet e plan veprimeve. Tabela 2 ne Seksionin III te ketij raporti identifikon disa nga problematikat themelore qe kane nevojte urgjente per tu zgjidhur. Gjate rrjedhes se zbatimit te reformes do te perballen edhe me ceshtjet te tjera.

15. Faza I – Janar deri ne Dhjetor 2008

63. MPPTT ka shprehur idene qe te behet operuese reforma e re organike e ARSH-se, me ardhjen e muajit Dhjetor 2008 dhe te perfundoje reforma organike ne Dhjetor 2009 qe realisht mund te arrihet vetem nese krijohet Njesia e Menaxhimit dhe RIT te nise punen nga Janari 2008 duke marre autoritetin dhe buxhetin e nevojshem qe te ndermarrin me tutje reformen ne gjith hapat e saj perkates. Gjate Fazes I Njesia e Menaxhimit mund te beje takime nje here ne muaj, mbeshetetur nga RIT dhe konsulentet e tyre te TA, te mundesoje menaxhimin e synuar per zbatimin e IRAP. Ne vecanti ata mund te sigurojne mbeshetje per menaxhim ne lidhje me rekomandimet e ndryshimeve themelore. RIT mund te siguroje vazhdimesine e skemes dhe momentin qe perfshin (i) hapat koordinues per te percaktuar me tej strukturen dhe hapesiren operuese per ARSH-n, (ii) akte ne mbeshetje te legjislacionit per krijimin e saj, (iii) tenderimin dhe angazhimin e sherbimeve te konsulences TA per te ndermarre me tej reformen dhe (iv) asistimin per nisjen e organikes se re dhe berjen e saj operuese

64. Faza I permban dymbedhete detyra qe jane pershkruar me poshte :

Detyra 1.1 Percaktimi i Njesise se Menaxhimit dhe RIT

Anetaret e Njesise se Menaxhimit mund te perzgjidhen nga Minisri mes stafit kryesore ne MPPTT dhe MF dhe me institucionet e tjera qe kane rendesi ne zbatimin e reformes. Konsulentet sugjerojne se RIT do perfshihet perkatesisht nga gjashte persona mes Drejtoreve dhe Keshilltareve te Ministrise. Mund te konsiderohet per sa meposhte:

- Z. Ervin Minarolli, Drejtor i Pergjithshem i Politikave dhe Planifikimit te Transportit dhe Telekomunikacionit,

- Z. Andi Toma, Drejtor i Pergjithshem i Sherbimeve Ligjore Mbeshetese,

- Z. Ernest Noka, Sektori Privat,

- Z. Perparin Cani, Keshilltar,

- Znj. Lejla Saraci, Drejtore e Pergjithshme e DPR

- Z. Patrick Treacy, PB ECORYS Drejtuesi i Njesise per Asistencen Teknike

Detyra 1.2 Ligji qe duhet per te krijuar ARA-n

RIT mund te pergatise paraprakisht legjislacionin qe stabilizon ARSH-ne dhe percakton autonomine e saj, strukturen e menaxhimit, organiken, procedurat e operimit dhe administrimin si edhe pergjegjesine dhe marredhenien ndermjet qeverise dhe paleve te sektorit privat qe jane angazhuar ose mbeshtesin ndertimin, mirembajtjen dhe operimin e rrjetit te rrugeve nacionale. Legjislacioni mund te percaktojte perberjen dhe termat e sherbimit dhe autoritetin e Bordit te Menaxhimit si edhe njesite operuese themelore brenda ARSH-se.

Detyra 1.3 Financimi qe merret per Zbatimin e ARSH-se

RIT mund te pergatise nje vleresim te detajuar te llogarive financiare qe jane kerkuar per te

nisur reformen qe perfshin gjithë shpenzimet e pritshme per Vitin Financiar 2009, ku permbledhen gjithë kërkesat e rishikuara per pagesat, asistencë teknike dhe shërbimet e pajisjet e nevojshme per forcimin e strukturese ARSH-se. Informacioni duhet te prezantohet ne nje format te caktuar per MPPTT, me qellim qe me pas te kerkohet alokimi i buxhetit ne MF, per financime te jashtme ne mbështetje te reformes. Tabela 6 ne seksionin V permban nje kosto te perafert te kërkesave financuese.

Detyra 1.4 Prezantimi per Tenderimin e Asistences Teknike

RIT mund te nise tenderimin per asistencen teknike qe mbështet MPPTT ne zbatimin e IRAP duke perfshire: (i) finalizimin e TeR per Asistencen Teknike³, (ii) marrjen e masave per te siguruar financim per Asistencen Teknike nga IFI ose nga Buxheti Investimit, (iii) duke publikuar propozimet e kerkuara nga kompanite e kualifikuara, dhe (iv) propozimet vleresuese. TeR perfshijne kërkesen per huazimin e nje kompanie konsulence per gjithë mbështetjen e shërbimeve por MPPTT mund te vendose per te zgjedhur konsulente te specializuar per detyra te caktuara.

Detyra 1.5 Fuqizimi i Legjislacionit per te krijuar ARSH-ne

Ligji qe stabilizon ARSH-ne mund te paraqitet ne Keshillin e Ministrave. Me prezantimin e tij (VKM) nje rekomandimi do ti behet Parlamentit per miratim. Pritet qe legjislacioni per ngritjen ARSH-ne te hyje ne fuqi nga fundi i Korrikut 2008.

Detyra 1.6 Angazhimi i Konsulentëve TA

Procesi i tenderit per asistencen teknike mund te perfundoj ne te njejten kohe qe hyn ne fuqi legjislacioni i ARSH-se. Kur te hyje ne fuqi legjislacioni atehere kontrata e TA mund te prokurohet dhe keshtu mund te nise mobilizimi i Konsulentit. Konsulenti i TA mund te mbështese RIT sic kerkohet si dhe te pergatise detyrat e vecanta te identifikuar ne TeR.

Detyra 1.7 Pergatitja dhe Marreveshja e Ushtrimit te Shërbimeve

Sapo te percaktohet legjislacioni qe llogjtitimon ARSH-ne ateher MPPTT do sjelle ne fuqi Marreveshjen e Ushtrimit te Shërbimeve⁴ ndermjet Qeverise dhe ARSH-se duke bere te mundur keshtu percaktimin e gjithë marrëdhënieve ndermjet paleve. Kjo marreveshje mund te nenvizohet mire ne legjislacionin qe percakton ARSH-ne, duke caktuar fuqite dhe autoritetin qe delegohet, nivelet e mbështetjes dhe pergjegjesite per shperndarjen e shërbimeve. Disa nga ceshtjet me themelore qe ka kjo marreveshje jane:

- Pergjegjesite e ARSH-se duke perfshire masat e performances; dhe autoritetin ne ceshtjet lidhur me kryerjen e shërbimeve themelore;
- Perberja e Bordit te Menaxhimit; perfshijne anetaret, mandatin, autoritetin, vendim marrjen, emerimin dhe zevendesimin e anetareve dhe kompensimin;
- Manualet e burimeve njerezore; perfshijne perzgjedhjen, emerimin, kompensimin, vleresimin e punes dhe zevendesimin e stafit;
- Nivelet financuese nga burimet e Qeverise dhe marrëdhëniet ne masat e punes si dhe autoriteti per te kerkuar financime shtese nga burime alternative.

Detyra mund te perfshije nje permbledhje nga RIT e mbështetur nga konsulentet e TA per opsionet per kompensime te caktuara per stafin e ARSH, e bazuar ne praktikat me te mira te vendeve fqinje, entet e tjera qeverisese dhe sektorin privat ne Shqiperi.

Detyra 1.8 Emerimi i Bordit te Menaxhimit dhe Rekrutimi i Stafit

RIT mund te kontaktoje agjensite ose organizatat e aktoreve te interesuar brenda dhe jashte qeverise qe mund te emeroje kandidatet per Bordin e Menaxhimit, te vleresoj kandidatet e propozuar dhe te pergatise listat e kandidateteve te rekomanduar per tu marre parasysh nga Ministri i MPPTT. Bordi i Menaxhimit pritet qe te behet operues nga Tetori 2008. RIT mund te ndihmoj gjithashtu ne rekrutimin e stafit, duke perfshire rishikimin e kualifikimeve te aplikantit dhe vleresimin. Listat e kandidateteve te kualifikuar mund te paraqiten ne Bordin e Menaxhimit (ose CEO pas emerimit). Rekrutimi i stafit do perfundoje ne fund te Dhjetorit 2008 dhe ARA mund te behet operuese per te nisur pune ne 1 Janar 2009.

Detyra 1.9 Pergatitja Dokumnetacionit te Brendshem per ARSH-ne dhe Transferimi i Funksioneve nga DPRr ne ARSH

³ TeR draft per aistencen teknike qe te mbështetet RIT ne stabilizimin dhe perforcimin e ARA-s qe jane referuar ne Shtojcen V te ketij raporti.

⁴ Nje shembull i marreveshjes se shërbimit tregohet ne Shtojcen VI te ketij raporti.

Me ndihmen e konslenteve të TA, Njesia e Zbatimit mund të mbështesë nisjen e funksionimit të ARSH-se. Kjo mund të përfshijë vendime për shërbimet nëpër zyra, transferimin e arkivave, pajisjeve dhe përgjegjësi të operuesve nga DPRr në ARSH dhe përmirësimin e shërbimeve që përfshijnë përfundimin e Teknologjisë së Informacionit. Konsulentet e TA mund të mbështesin RIT, edhe në përgatitjen e dokumentacionit të brendshëm të ARSH-se duke përfshirë rregulloret, procedurat operuese dhe përkrahimin e pozicioneve në përputhje me strukturën e re dhe hapësirën operuese të saj.

Detyra 1.10 Legjilacioni Rregullator i Rekomanduar

Ekspertët ligjorë të punësuar nga MPPTT mund të prezantojnë një përmbledhje të detajuar të kuadrit rregullator për transportin rrugor dhe fushat e rekomanduara për legjilacionin e ri ose përmirësimin e legjilacionit ekzistues. Fusha e interesit të vecantë përfshijnë prokurimin, shpërndarjen, hyrjen me rrjet të tokave private, dimensionet e automjeteve dhe kontrollin e peshës, sigurinë rrugore dhe mbrojtjen ambjentale.

Detyra 1.11 Prezantimi i Teknologjisë së Informacionit

Konsulentet e TA, në bashkëpunim me MPPTT dhe Institutin e Teknologjisë, mund të përgatisin rekomandime dhe të instalojnë Teknologjinë e Informacionit me gjithë mundësitë dhe kapacitetet që ofron ARSH përfshirë servera, projektimin e rrjetit dhe sistemet e komunikimit;

Detyra 1.12 Nisja me HRMS, SOP dhe FAPMS

Konsulentet e TA mund të fillojnë përgatitjen e sistemeve të mëposhtme për ARSH-në:

Sistemet e Menaxhimit të Burimeve Njerezore (HRMS) me përberes (i) marrëdhëniet dhe funksionet e detajuara dhe përgjegjësitë e zyrtare drejtuese dhe njësive rajonale dhe marrëdhëniet me organizatat tjera të sektorit, (ii) vlerësimin për aftësitë e kërkuara për kryerjen e këtyre funksioneve dhe trajnime dhe/ose kërkesat e reja të rekrutimit, (iii) Planin Strategjik Operues (OSP) që identifikon rolet e menaxhimit, përgjegjësitë dhe qëllimet e punës që janë sugjeruar si dhe mënyrën e përcaktimit të tyre për të përmbushur qëllimet e vendosura në sektorin rrugor,

- Planin Strategjik Operues (SOP), një plan afat mesëm me investimet e taksave që lidhen me procesin e buxhetit; 5

- Sistemet e Financës dhe Monitorimit të Projekteve (FAPMS) që dokumentojnë menaxhimin financiar dhe praktikën e llogaritjes për ARSH-në në përputhje me ligjin e Korporatës në Shqipëri që karakterizohet nga (i) transparencë, (ii) shpjegimi dhe standarnizimi i procedurave të buxhetimit dhe llogaritjes, dhe (iii) rritjen e delegimeve dhe decentralizimit.

16. Faza II – Janar deri në Dhjetor 2009

65. Nderkohe që ARSH nis operimin e saj, RIT mund të vazhdojë funksionin e vet, drejt përqendrimit të konsolidimit si dhe mbështetjes së organikes së re me instalimin e sistemit të informacionit, trajnimin e duhur të stafit dhe përshtatjen e procedurave operuese në mbështetje të sistemeve të reja dhe përmirësimit dhe zhvillimit të ambientit rregullator. Faza dy përmban shtatë detyra që janë parashikuar më poshtë.

Detyra 2.1 Fuqizimi i Legjislacionit Rregullator

Konsulentet e TA mund të përgatisin një legjislacion të vecantë për reformën e rekomanduar sipas detyrës 1.10. I cili miratohet me pas nga MPPTT. Ky legjislacion do modifikohet dhe miratohet në bazë të kërkesave në vazhdim.

Detyra 2.2 Zbatueshmëria e HRMS

HRMS do kompletet dhe të tëra politikat organike, procedurat, rolet, përgjegjësitë dhe planet e kompensimit miratohen nga Bordi i Menaxhimit. Bordi i Menaxhimit do miratojë gjithashtu trajnimet dhe planin e ndërtimit të kapaciteteve si dhe alokojë fonde për zbatueshmëri të metejshme të tij.

Detyra 2.3 Zbatueshmëria e FAPMS

Konsulenti i TA do operojë nëpërmjet FAPMS për të siguruar informacion mbi menaxhimin e shpenzimeve, progresin e projektit dhe procedurat për ecurine fizike e financiare të tij. Sistemi mund të testohet me pare në një nga zyrtarët drejtues të rajonale të ARSH-se, me pas do behen modifikimet e nevojshme dhe stafi i ARSH-se do të trajnohet të përdorë sistemin.

⁵ SOP do mbulojë rrjetin nacional që është shtuar e përcaktuar nga asistencë teknike e Bankës Botërore dhe Projektet e Rrugëve Lokale të miratuara nga MPPTT.

Detyra 2.4 **Perfundimi i SOP**

SOP, nje plani strategjik per zhvillimin, rehabilitimin dhe mirembajtjen e rrugeve. Si pjese brenda SOP do te krijohet nje database rruges mbi nje platforme GIS me program per azhurnimin e tarifave te buxhetit investues.

Detyra 2.5 **Zbatimi i Sistemeve te Informacionit**

Zbatimi, nga konsulentet e asistences teknike, i sistemeve te informacionit duke formuar aftesite online ne zyrtat qendore dhe nje strukture te pershtatshme per futjen e te dhenave nga zyrtat e qarqeve. Informacioni i manaxhuar do te sigurohet per proceset kyce qe perfshijne planifikimin, tenderimin, llogarite dhe monitorimin e rezultateve te punes se projekteve

Detyra 2.6 **Forcimi i Mekanizmave te Dhenies se Sherbimit**

Rishikimi, nga konsulentet e TA, i procedurave per ofrimin e sherbimit perfshire ketu procedurat permiresuese, forcimi i TOR dhe zhvillimi i manualeve operacionale. Fushat me interes me te vecante perfshijne:

- Pergatitja e nje Manuali Mbikqyres per Mirembajten dhe Ndertimin. Ky manual duhet te tregoje menytrat se si dokumentohen procedurat per garantimin e cilesise nga Kontraktori, Inxhinieri dhe Punedhenesi ne perputhje kjo me formularet e kontrates se sipermarrjes qe eshte miratuar per Shqiperine dhe e cila permban seksione qe percaktojne: (i) rolin e paleve te Kontrates Ndertimore, (ii) tipet dhe modelet e korrespondencave per secilen pale kontraktuale, (iii) shqyrtimi dhe monitorimi i perputhshmerise se planit te kontraktorit per garantimin e cilesise dhe (iv) perputhshmeria me standardet shoqerore, mjedisore dhe te sigurise rrugore;

- Shqyrtimi i procedurave te shpronesimit, eksplorimi dhe testimi i varianteve te punesimit te konsulenteve per ceshtjet e shpronesimit, zhvillimit te TOR dhe asistences per proceset e preferuara te zbatimit;

Detyra 2.7 **Organizimi i Trajnimeve**

Pergatitja, nga konsulentet e asistences teknike, e nje plani per dhenien e nje programi per zhvillimin e kapaciteteve perfshire ketu identifikimin e nevojave per trajnim, hartimin e materialeve trajnuese, identifikimin e institucioneve ne Shqiperi te afta per te dhene trajnimet e kerkuara dhe per te ndihmuar ne zhvillimin e materialeve dhe organizimin e trajnimeve ne pese fusha strategjike:

- Parimet e Manaxhimit,
- Sistemet dhe Teknologjia e Informacionit
- Manaxhimi Financiar
- Prokurimi
- Garantimi i Cilesise ne projektim, shpronesim, ndertim dhe mirembajtje ne perputhje me manualet mbikqyrese te ARSH per projektim dhe ndertim;

Vleresimi i nevojave per trajnim do te plotesoje nevojat e personelit te ARSH dhe te ayre qe japin sherbimin. RIT do t'i paraqese Bordit te Manaxhimit variante per dhenien e trajnimeve dhe do te kerkoje edhe miratimin dhe financimin e programit te trajnimeve per ARSH. Subjektet e sektorit privat qe jane te perfshire ne dhenien e sherbimeve do t'i perballojne vete kostot e trajnimeve per personelin e tyre.

66. MPPTT pritet te ndermarre hapat e duhur per ngritjen e punes baze per permiresimin e produktivitetit te sektorit. Keto hapa perfshijne:

- Nje master plan per sistemin e informacionit i cili percakton rolet e agjencive te transportit rrugor ne te dhenat baze treguese, standardet teknike per teknologjine e informacionit, platforma hardware, arkitekturen e rrjetit dhe aftesite per komunikimin e te dhenave si dhe rekomandon nje plan me faza per instalimin e komponenteve te sistemit ne MPPTT, ARSH dhe agjencite e tjera;

- Nje Sistem per Manaxhimin e Pasurive Rrugore me komponentet per (i) inventarizimin e kushteve dhe tipareve te rruges, (ii) planifikimin, buxhetimin dhe percaktimin e standardeve te punes dhe monitorimin e mirembajtjes rutine dhe periodike dhe (iii) monitorimin e ndikimit qe mund te kene patur ne rruge strategjite e e miratuara te mirembajtjes.;


- Nje Sistem Online per Manaxhimin e Informacionit te transportit rrugor me aftesine e vleresimit te informacionit nga perdoruesit e autorizuar nderkohe qe lejon cdo njesi operuese qe te

ngreje dhe manaxhoje databaza ne perputhje me kerkesat e vacanta te organizates.

17. Programi Kohor per Zbatimin e Planit te Veprimit

67. Programi kohor i zbatimit te planit te veprimit qe jepet ne Figuren 5 tregon datat qe mendohet te perfundoje secili prej hapave te nevojshem qe duhen per transformimin e DPRr ne ARSH, nje Ndermarrje Publike e qendrueshme dhe me rendiment pune te larte. Aktiviteti kryesor i RIT do te jete monitorimi i seciles prej ketyre detyrave, ndermarrja e veprimeve per zgjidhjen e problemeve qe mund te hasen/dalin, azhornimi, te pakten, mujor i planit, raportimi tek Ministri i MPPTT dhe Njesia e Menaxhimit gjate Fazes I dhe Bordit te Menaxhimit gjate fazes II, si dhe rekomandimi i veprimeve per zgjidhjen e problemve dhe mbajtja e ritmit/momentit kyc te procesit reformues.

Figura 5 Programi Kohor i Planit te Veprimit per Reformen Institucionale.



V. CESHTJET ME TE RENDESISHME PER NJE ZBATUESHMERI TEPER TE SUKSESSHME

18. Ceshtjet me te rendesishme per Zbatueshmeri te suksesshme

68. Kuadri i reformes dhe plan veprimi eshte pergatitur pas shume konsultimeve mes MPPTT, DPRr dhe konsulentëve TA te angazhuara nga keto agjensi. Strategjia e reformes se propozuar, ndersa nuk duket e perputhshme me studimin e ANTP dhe propozimet e tjera te reformes, permbajne disa modifikime qe Konsulentet bespjne se mund te ndohmojne ne shtytjen me tej te procesit te reformes. Nepermjet diskutimeve mes drejtuesve te MPPTT dhe DPRR eshte shume e dukshme se strategjia e pergjithshme ka nje mbeshtetje te madhe dhe duhet te ndiqet. Disa nga veprimet per reformat specifike mund te kerkojne bisedime te metejshme. Kjo eshte shume e rendesishme dhe duhet te vazhdoje gjate gjithë rruges se zbatimit te planit. Disa nga ceshtjet e ngritura ne seminarin e rishqyrtimit te reformes, mbajtur ne Tirane ne muajin Shtator 2007 dhe nga komentet e dhena per raportin DFR, jane permbledhur ne Tabelen 3 ne Seksionin III te ketij raporti. Disa hapa te tjere te rendesishem per zbatimin me sukses te plan veprimit te reformes per qellimin e realizimit te saj ne muajin Dhjetor, 2009 perfshijne:

- Caktimin e Njesise se Menaxhimit dhe RIT,
- Kostot e nisjes se procesit,
- Vizita ne vendet qe kane zbatuar po te njejten reforme,
- TA te mbeshtese Njesine e Zbatimit te Reformes.

69. Tabela 4 me poshte tregon numrin e kilometrave te Rrugeve Nacionale qe tashme jane percaktuar per cdo rajon. Sic mund te shihet gjatesia e Rrugeve Nacionale varion nga 153 km ne Berat deri 509 km ne Shkoder. Me riklasifikimin pritet qe rrjeti ne cod rajon do rritet me afersisht 30%. Edhe me kete shtese ngarkesa ne rruge mund te mos shperndahet me nje ngarkese me te rende ne Shkoder se san e rajonet e tjera, vecanerisht kur impkati i mirembajtjes se dimrit merret parasysh. Per kete arsye rekomandohet qe te reduktohen ne 3 rajone sipas rekomandimit te studimit te ANTP. Ky rekomandim ka perfitimet e meposhtme:

- Bazohet ne ngarkesen e meparshme me me shume rrjete te balancuara;
- Eshte ne perputhje me premisen e miratuar qe te gjitha sherbimet mund te kryhen nga sektori privat dhe qe cdo rajon efektivisht mund te menaxhoje nje rrjet me t emadh rrugor keshtu qe ulen kostot administrative te ARs.

Tabela 4 Gjatesia e Rrugeve Nacionale ne Rajonet e DPRr

<i>Diber</i>	<i>Kukes</i>	<i>Shkoder</i>	<i>Lezhe</i>	<i>Tirana</i>	<i>Durres</i>	<i>Elbasan</i>	<i>Fier</i>	<i>Berat</i>	<i>Vlora</i>	<i>Gjirokaster</i>	<i>Korce</i>
254	284	509	231	244	165	375	240	153	444	302	395

70. Pritet qe Keshilli i Ministrave te marre ne konsiderate dhe te vendose per krijimin e ARA-se ne muajin Janar 2008. Duhet miratuar propozimi nga Keshilli e me pas te krijohet menjehere RIT, dhe krijimi i Njesise se Menaxhimit e cila eshte shume e rendeishme qe te perkoje me perputhshmerine e realizimit te gjithe qellimeve qe jane vendosur per krijimin e ARA-s ne kohen e caktuar qe perkon me muajin Dhjetor 2008, e me pas te behet operuese e te nise tamam punen ne muajin Dhjetor 2009. Paragrafi 66 i ketij raporti permban nje liste me gjithe anetaret e sugjeruar te RIT.

71. Nje investim i rendesishem kerkohet qe te zbatoje e beje te mundur operimin e reformes se propozuar por ky investim eshte i kenaqshem me objektivat qe permban ne arritjen dhe realizimin e ARSH-se dhe pajisjen e gjithe parametrave te kenaqshem te investimeve ne sektor per perdoruesit rrugore. Llogaritjet jane dhene ne Tabelen 5 ku shihen kostot per asistencen teknike ne mbeshtetje te veprimtarive qe jane pershkruar ne kete sektor si edhe pajisjet e makinerite qe nuk disponohen aktualisht nga DPRr. Kosto e fillimit te veprimtarise prej US\$ 4.2 milione perfaqeson me pak se 1 % te buxhetit aktual te DPRr. Duke menduar se kemi nje projekt shume real me 10% permiresime ne produktivitet me ane te ketij investimi, ne vitin e pare do vlere e financimit do te kompensohet me me shume se 15 here nga investimi i parashikuar.

Tabela 5 Llogaritja e koston per stabilizimin e ARSH

	Person Months		Monthly Rate		Reimbursables	Cost (\$ US)
	Local	Foreign	Local	Foreign		
Individual TA support to RIT		5		17,500	35,000	122,500
Regulatory Framework	8		4,000		1,000	33,000
Internal Documentation	8		4,000		1,000	33,000
Strategic Options Plan	36	15	4,000	25,000	141,000	660,000
HRMS	30	4	4,000	25,000	40,000	260,000
Information Systems	30	6	4,000	25,000	60,000	330,000
Capacity Building (Training)	24		4,000	25,000	30,000	126,000
FAPMS	28	6	4,000	25,000	60,000	322,000
Supervision Manual	24	4	4,000	25,000	40,000	236,000
Sub Total -Technical Assistance	188	35				2,122,500
Average Salary Increase for ARA Staff *	1380		700			966,000
Office Improvements						225,000
Vehicles and Equipment						500,000
Contingencies						386,500
Total Estimate						4,200,000

* 113 employees for 12 months at average salary increase of \$750 per month

72. TeR per mbeshitetjen e RIT perfshihen ne Shtojcen V te ketij raporti. Mbetet e rendesishme qe RIT ti shqyrtoje keto TR dhe te vleresoje ato apo te propozoje qe rregullimet ne staf te reflektojne gjithë aftesite dhe ekspertizen e mundshme ne Shqiperi. Qellimi i propozuar perfshin mbeshitetjen per zhvillimin e sistemeve, kapacitetin e burimeve njerezore dhe manualet per ARSH.

SHTOJCAT
SHTOJCA I
ZYRTARET QE U KONSULTUAN

Shtojca I...

a. ZYRTARET QE U KONSULTUAN

Ministria e Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacioneve (MPPTT),
Qeveria e Shqiperise

H. E. Sokol Olldashi, Ministri

Z. Ervin Minarolli, Drejtor i Pergjithshem i Politikave dhe Planifikimit te Transportit dhe
Telekomunikacionit

Z. Andi Toma, Drejtor i Pergjithshem i Sherbimeve Ligjore Mbeshtetese

Dr. Inxh. Kujtim Hashorva, Drejtor i Politikave te Transportit Rrugor

Znj. Yllka Zaloshnja, Drejtore e Planifikimit Financiar dhe Statistikave

Znj. Jonida Baci, Shefe e Kabinetit

Z. Jgli Peci, Departamenti Ligjor

Z. Perparin Cani, Keshilltar

Znj. Lejla Saraci, Keshilltare

Z. Gerti Veshaj, Keshilltar

Z. Patrick Treacy, PB ECORYS Drejtuesi i Asistences Teknike

Z. Robert Lamond, PB ECORYS Asistenca Teknike

Banka Boterore

Z. R. Martin Humphreys, Ekonomist i Larte per Transportin, Washington

Z. Artan Guxho, Oficer Projektsh, Tirane

BASHKIMI EUROPIAN

Z. Daniele Maniscalco, Menaxheri Transporti, Seksioni Nderhyrjes II

BANKA EUROPIANE PER RINDERTIM DHE ZHVILLIM

Z. Donald Mishaxhi, Drejtor

BASHKEPUNIMI ITALO SHQIPTAR

Z. Carlo Lambiase, Keshilltar Infrastruktore

Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve ne Tirane

Inxh. Ilirjan Berzani, Drejtor i Pergjithshem

Inxh. Skender Cota, Zv. Drejtor i Pergjithshem

Inxh. Thoma Xhori, Drejtor Teknik

Inxh. Mimoza Prushi, Drejtore e Menaxhimit te Kontratave

Z. Xhevair Mugogllava, Drejtor i Planifikimit dhe Koordinimit

Z. Arjan Ceti, Drejtori Ligjor

Z. Gramoz Qendro, Drejtor i Burimeve Njerezore

Inxh. Edmond Alite, Drejtor i Sherbimeve te Trafikut

Inxh. Ermal Nuri, Shef i Laboratorit

Njesia e Zbatimit te Projekteve, DPRr

Inxh. Ylli Gjoni, Zv. Drejtor i Pergjithshem

B.Inxh. Adem Duka, Menaxher Projekti

C.Inxh. Steven Kay, Keshilltar Teknik

Drejtoria Rajonale e Korces

- Inxh. Gentian Pere, Drejtori Drejtorise Rajonale Korce
 - Inxh. Oltion Xhamo, Drejtori Teknik
 - Inxh. Natasha Dhamko, Seksioni Teknik
 - Znj Poliksena Peti, Drejtore e Burimeve Njerezore
 - Znj. Mirela Nano, Seksioni i Burimeve Njerezore
 - Znj. Lojola Malellari, Financa
 - Znj. Miranda Nuno, Arkiva
-

Perfaqesues nga Komuniteti, Kontraktore dhe Konsulente

- Inxh. Anastas Rista, SHANARR Kompani Kontraktore
- Z. Robert Butler Louis Berger SAS
- Znj. Jeanne Breen, Konsulent per Sigurine Nderkombetare Rrugore
- Z. Eric Howard, Konsulent per Strategjite e Sigurise Rrugore
- Z. Gezim Bimbli, General Manager, Kompania Albegis
- Inxh. Fatos Galanxhi, STUDIOTET Ltd.
- Znj. Nereida Hoxha, Konsulente ne MPPTT
- Z. Ilir Hodo, Konsulente ne MPPTT

SHTOJCA II
VEPRIMTARITE KRYESORE TE NJESIVE TE ARA- S

Njesia	Aktivitetet Kryesore
Njesia e Projekteve me Financime te Huaja	Rekomandohen qellimet e punes ne ceshtjet qe lidhen me projektet e financuara nga IFI funded dhe projektet e tjera qe caktohen per Njesine e CEO-s (Projektet EF); Te bashkepunohet me NjPFJ ne lidhje me projektet e propozuara dhe kredite qe jane ne vazhdim; Te behet e ditur dhe te monitorohet perputhshmeria me kerkesat e cdo projekti te NjPFJ; Kryerja e detyrave ligjore dhe administrative e lidhur me tenderimin dhe punen e kontraktoreve Njohja me procesin e tenderimit per gjithë projektet e financuara nga NjZPJ ne perputhje me ligjin Shqiptar dhe kerkesat specifike te NjPFJ; Te kryhen detyrat e Perfaqesuesit te Punedhenesit per projektet EF; Te kryhen detyrat e Supervizionit per gjithë projektet ne te cilat ky aktivitet nuk kontraktohet pa perfshire Studimet, Projektet dhe Sistemet e Informacionit; Te monitorohen ecurite financiare dhe fizike te projekteve; Te pergatiten raportet sic duhen dhe te raportohet per menaxhimin, perdoruesit rrugore dhe NjPFJ; Te aplikohen procedurat administrative dhe te mirembahet arkiva ne perputhje me kerkesat e ARSH-s dhe NjPFJ; Te asistohet me pergatitjen e llogaritjes se buxhetit per njesine; Te kryhen te gjitha veprimtarite e tjera qe kerkohen per perfundimin e suksesshem te projekteve; Te njihet stafi me vleresimet dhe te monitorohet ne perputhje me qellimet e punimeve; Te mbeshtetet zbatimi i programit te kapaciteteve te burimeve njerezore per Njesine.
Njesia e Sherbimeve Rajonale	Rekomandohen qellimet e punes per ceshtjet qe lidhen me projektet e caktuara per Njesine (Projektet RS); Pergatitja e gjithë koordinimit dhe supervizionit per veprimtarite e Drejtorive Rajonale (DR); Te kategorizohen projektet qe do financohen nga investimet e buxhetit si edhe Projektet e Investimeve te Medha, qe do tenderohen nga Zyrat Drejtuese, ose Projektet e Investimeve te Vogla qe do tenderohen nga DR; Te kryhen gjithë detyrat ligjore dhe administrative qe lidhen me tenderimin dhe punimet e paleve te kontraktuara; Te rishikohet manuali i projektit dhe te angazhohen konsulentet sic kerkohet per te permiresuar manualin dhe per te pasqyruar politiken aktuale; Te aplikohen procedurat administrative dhe te mirembahen arkivat ne perputhje me regulloret e ARSH-s; Te pergatiten raportet sic kerkohen dhe te raportohet per menaxhimin e perdoruesve rrugore; Te asistohet me pergatitjen e llogaritjes se buxhetit per njesine; Stafi te kryejë vleresimet dhe te monitorohet perputhshmeria me qellimet e punes se Njesise; Te mbeshtetet zbatueshmeria e programit te kapaciteteve per Burimet Njerezore te Njesise; Te kryhen te gjitha veprimtarite e tjera qe kerkohen per perfundimin e suksesshem te projekteve.
Njesia e	Te koordinohen dhe mbikqyren veprimtarite e Drejtorive Rajonale;

Njesia	Aktivitetet Kryesore
Sherbimeve Rajonale per Njesine e Sherbimeve	Te mbeshteten Drejtoret Rajonale per zgjidhjen e ceshtjeve; Te kryhen gjithë inspektimet periodike ne nivel rajonal per te monitoruar perputhshmerine me standartet dhe proceset e ARSH-s dhe te rishqyrtohet ecuria e veprimtarive ne vijim; Te konsultohet dhe koordinohet me Bordin e Rrugeve Rajonale ne lidhje me projektet ne vazhdim dhe te propozuara dhe per statusin e veprimtarive ne vazhdim; Stafi te kryeje vleresimet dhe te monitorohet perputhshmeria me qellimet e punes se Rajoneve; Te koordinohet programi i ndertimit te kapaciteteve njerezore per Drejtorite Rajonale.
Njesia e Prokurimit	Te pergatitet modeli TOR bazuar ne manualet e ARSH-s dhe dokumentacioni tjetër dhe prodhimi i praktikave me te mira; Te njihet me procesin e tenderit ne perputhje te plote me ligjin Shqiptar; Te kryhen gjithë detyrat e tjera qe kerkohen per prokurimin e suksesshem te sherbimeve per ARSH-n.
Njesia e Zbatimit te Projekteve	Te kontrollohen kompanite qe jane angazhuar meurvejimin e procesit te shpronesimeve ose te kryhet ky aktivitet kur nuk kontraktohet; Te kryhen detyrat e Perfaqesuesit te Punedhenesit per Projektet e Investimeve te Medha; Te inspektohen kantieret e projekteve dhe te perforcohen kerketat e ARSH-s per nje trafik sa me te rregullt dhe sigurte; Te kryhen detyrat e Supervizionit per projektet sic jane Studimet dhe Sistemet e Informacionit ku nuk eshte bere kontraktim; Te monitorohet ecuria financiare dhe fizike e projekteve;
Drejtoria Rajonale (DR)	Te kryhen detyrat e Perfaqesuesit te Projektit per projektet e DR; Te kryhen detyrat e Supervizionit per projektet e DR vetem kur drejtohen nga Njesia e Sherbimeve Rajonale; Te kontrollohen kompanite e angazhuara nga DR (Projektet e DR) qe te kontrollojne ne terren procesin e shpronesimit ose te kryejne kete veprimtari kur ajo nuk eshte kontraktuar; Te kryhen detyrat e Perfaqesuesit te Punedhenesit per projektet e DR; Te kryhen detyrat e Supervizionit per gjithë projektet e DR kur nuk behet kontraktim; Te inspektohen kantieret e projektit dhe te perforcohen sa me mire detyra e ARSH-s per trafik sa me te sigurt; Te miratohe blerjet dhe disbursimet ne perputhje me procedurat e ARSH-s dhe ligjin Shqiptar; Monitorimi i ecurise se projekteve DR nga ana teknike dhe financiare; Aplikimi i procedurave administrative dhe mirembajtja e arkivave ne perputhje me rregulloret e ARSH-s; Pergatitja e raporteve dhe raportimi i menaxhimit, Bordi i Rrugeve Rajonale dhe perdoruesit rrugore; Asistimi me ane te pergatitjes se llogaritjes se buxhetit per drejtorine; Stafi te kryeje vleresimet dhe te monitoroje perputhshmerine me qellimet e punes; Te mbeshtese zbatueshmerine programit te ndertimit te kapaciteteve te burimeve njerezore per drejtorine; Te pergatiten vleresimet e stafit; Te kryhen veprimtari te tjera qe duhen per te perfaqesuar ARSH-n ne rajon.
Njesia e Sigurise se Kontrollit	Te rekomandohet ne qellimet e punes qe kane t ebejne me sigurimin e cilesise; Mbikqyrja e veprimtarive per Nderhyrjet, Sigurine Rrugore dhe Njesite e

Njesia	Aktivitetet Kryesore
(SK)	Ambjentit si dhe mbeshetja e perputhshmerise dhe zbatimit te vendimeve te politikave sic rekomandohet per keto njesi; Permiresime te rekomanduara per manualin e supervizionit qe pasqyron praktikat me te mira aktuale ne supervizionin e ndertimit. Te pergatiten Termat e References per Supervizionin e Punimeve dhe te koordinohet prokurimi i tyre me Njesine e Prokurimit; Mbikqyrja e aktiviteve te kompanive qe jane angazhuar me Njesine e SK; Mbeshtetja e njesive te tjera ne nivel zyresh drejtuese dhe rajonale per zbatimin e programit te ndertimit te kapaciteteve te burimeve njerezore per SK; Mbeshtetja dhe keshillimi i njesive DR ne lidhje me SK; Ruajtja e arkivave ne perputhje me rregulloret e ARSH-s; Te pergatiten raportet sic duhet dhe raportime per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Asistohet ne pergatitjen e kerkesave buxhtare per Njesine; Stafi te kryeje vleresimet dhe monitorimin ne perputhje me qellimet e punes te Njesise; Mbeshtetja e zbatimit te programit te ndertimit te kapaciteteve per burimet njerezore te Njesise; Kryerja e gjithe veprimtarive qe duhen per perfundimin e suksesshem te projekteve.
Njesia e Sigurise Rrugore	Te rekomandohen iniciativat e politikave se sigurise rrugore si edhe veprimtarite e sigurise brenda kuadrit politik dhe mbeshetja e zbatimit te tyre; Te rekomandohen modifikimet per manualin e projektit sic kerkohet per te pasqyruar praktikat me te mira ne sigurine rrugore; Te pergatiten Termat e References per punimet e sigurise rrugore dhe koordinimi i prokurimit te tyre me Njesine e Prokurimit; Supervizioni i punimeve te ketyre kompanive; Te mbeshetet dhe keshillohet njesia e ARSH-s ne zyrat drejtuese dhe Rajonet ne lidhje me sigurine rrugore; Te pergatiten raportet sic duhet dhe raportime per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Te mbeshetet zbatimi i programit te burimeve njerezore per njesine.
Njesia e Nderhyrjeve	Rekomandohet modifikim per projektimin dhe manualin e supervizionit te punimeve qe te pasqyrohen praktikat me te mira aktuale ne sigurimin e cilesise; Te mbikqyren kompanite per rishqyrtimin e projektit ne lidhje me projektet e investimeve te medha; Te monitorohet zbatimi i planit te sigurimit te cilesise Mnga ana e inxhinierve te supervizionit dhe kontraktoreve qe jane te angazhuar per projektet e investimeve te medha; Te mbeshetese dhe t ekeshilloje njesite e ARSH-s ne zyrat drejtuese dhe ne Rajonet ne lidhje me BNj; Te pergatiten vleresimet periodike te stafit dhe te monitorohet perputhshmeria me qellimet e punes; Mbeshtetja e zbatimit te programit per zhvillimin e burimeve njerezore te Njesise.
Njesia Sociale dhe e Ambjentit	Rekomandohet iniciativat per ceshtjet e mbrojtjes se ambjentit dhe sociale si edhe veprimtarite brenda kuadrit te politikave dhe mbeshetjen e zbatimit te tyre; Rekomandohet modifikimet per manualin e projektit qe pasqyrojne praktikat me te mira ne mbrojtjen ambjentale dhe sociale; Te kryhet kontraktimi i vleresimeve per impaktet sociale dhe ambjentale ne menyren e duhur; Te mbesheteten dhe keshillohen njesite e ARSH-s ne zyrat drejtuese dhe rajonet ne

Njesia	Aktivitetet Kryesore
	lidhje me impaktin social dhe ambjental; Te pergatiten raportet sic duhet dhe raportime per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Te mbeshitet zbatimi i programit te zhvillimit t eburimeve njerezore per Njesine.
Njesia e Planifikimit	Rekomandohen qellimet e punes per ceshtjet qe lidhen me strategjite e investimeve dhe planet e investimeve per sektorin e rrugëve; Pergatitja e Termave te References per studimet periodike qe lidhen me punimet ne rruge dhe planifikimin qe perfshin zhvillimin dhe rifreskimin periodik te mundesive strategjike (SOP),urvejimet e trafikut,vleresimin e kushteve rrugore, rishqyrtimin e menaxhimit te pasurive, peshen e automjeteve dhe dimensionet, riklasifikimin e rrugëve dhe programet e zhvillimit rajonal per projektet PT) dhe koordinimin e prokurimit te tyre me Njesine e Prokurimit; Supervizioni i veprimtarive te ketyre kompanive; Te merren ne pune konsulente qe pergatisin studimet periodike te punimeve rrugore dhe planifikimin qe perfshihet,urvejimet e trafikut, vleresimet e kushteve rrugore, vleresimin e rishqyrtimeve, peshen e automjeteve dhe dimensionet e tyre, riklasifikimin rrugor dhe programet e ecurise rajonale; Te monitorohet zbatimi i SOP dhe te raportohet per menaxhimin ne lidhje me perputhshmerine; Koordinimi dhe mbeshitetja per Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjiise (METE) ne lidhje me Sistemin Informacionit per Trafikun Qendror; Te ruhen te dhenat e planifikimit te rrugëve me Sistemin e Menaxhimit te Informacionit ne Rrjet (OMIS); Te aplikohen procedurat administrative dhe te ruhen arkivat ne perputhje me procedurat e ARSH-s; Te pergatiten raportet sic duhet dhe raportime per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Stafi te kryeje vleresimet dhe monitorimin ne perputhje me qellimet e punes; Mbeshitetja per zbatimin e programit te ndertimit te kapaciteteve per burimet njerezore te Njesise; Asistimi ne pergatitjen e kerkesave buxhetore per ARSH-n; Te kryhen gjithë veprimtarite e tjera qe kerkohen per perfundimin me sukses te projekteve. Qellimet e rekomanduara te punes mbi ceshtjet qe lidhen me njesite e angazhuara ne sherbimet financiare dhe administrative; Mundesimi i koordinimit te pergjithshem dhe supervizioni i veprimtarive te Njesise F&A
Njesia e Sistemit te Informacionit	Rekomandimi per qellimet e punes ne ceshtjet qe lidhen me sistemet e informacionit; Pergatitja e materialeve dhe njoftimi i drejtuesve te larte; ndergjegjesimi, perfshirja, mirekuptimi dhe mbeshitetja per Teknologjine e Informacionit me ane te trajnimit, takimeve dhe seminareve; Mbeshitetje MPPTT ne pergatitjen e nje master plani per sistemet e informacionit qe bazohet ne standartet e miratuara teknike; Mbeshitetje MPPTT ne ecurine e metejshme te perberesve te OMIS per nderthurjen e aplikimeve qe kerkon sektori rrugor qe mundesoje gjithë nevojat e menaxhimit te informacionit ne gjithë proceset themelore baze; Mbeshitetje njesise se Burimeve Njerezore ne organizimin e trajnimeve per gjithë stafin ne: (i) operimet themelore kompjuterike, duke perfshire hardware, sistemet e operimit, email dhe Internet, (ii) paktetat me themelroe per programet ne zyra, (iii) shfrytezimin e sistemeve perkatese te ketyre fushave te studimit dhe rolet e

Njesia	Aktivitetet Kryesore
	tyre profesionale; Te pergatiten Termat e References per nje kompani te specializuar per sistemet e hardware dhe mirembajtjen e rrjetit qe perfshijne mundesimin e nje sherbimi ne linje dhe koordinimin e prokurimeve me Njesine e Prokurimit; Te supervizojë punimet e ketyre kompanive; Te pergatiten raportet sic duhet dhe raportime per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Te asistohet ne pergatitjen e kerkesave buxhetare per njesine; Stafi te kryejë vleresimet dhe te monitorojë perputhshmerine me qellimet e punes; Mbeshtetje ne zbatimin e programit te ndertimit te kapaciteteve te burimeve njerezore per Njesine.
Njesia e Burimeve Njerezore (BNj)	Rekomandim qellimesh pune per ceshtjet qe lidhen me menaxhimin e burimeve njerezore; Te ruaje dhe te permiresojë Sistemin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore (HRMS) te bazuar ne strukturen e percaktuar te ARSH-s, politikat, pershkrimin e prozicionit dhe klasifikimin; Te pergatiten TeR per konsulentet qe te zbatojne programet e ndertimit te kapaciteteve te BNj, te koordinoje me Njesine e Prokurimit per angazhimin e nje kompanie ose institucioneve per njohjen me trajnimet dhe supervizionin e punes se paleve te kontraktuara; Te supervizohen veprimtarite e ketyre kompanive; Te mbeshtese sistemin e vleresimit te punes se punonjesve ne baze vjetore, qellimet e punimeve dhe te inkurajoje rritjen e aftesive dhe arritjet e rezultateve te mira ne pune; Te aplikohen procedurat administrative dhe te ruhen arkivat ne perputhje me rregulloret e ARSH-s; Pergatitja e raporteve dhe raporti per menaxhimin dhe perdoruesit rrugore; Te asistojë me pergatitjen e kerkesave buxhetore per njesine dhe nevojat operuese per ARSH-n; Te kryhen gjithë veprimtarite qe nevojiten per mbeshtjetjen e stafit te ARSH-s; Te behen vleresimet dhe monitorimi i BNj ne perputhje me qellimet e punes.
Njesia e Finances	Rekomandohen qellimet e punes per ceshtjet qe lidhen me menaxhimin financiar; Te zbatohen dhe operohet me ane te Sistemit per Monitorimin e Projekteve dhe Kontabilitetin (FAPMS); Te caktohen kontrolle te pavaruara me asistencen per njesine e prokurimit sic kerkohet dhe te mbikqyren veprimtarite e tyre; Te caktohen auditore te pavarur; Te pergatitet kerkesa buxhetare per ARSH-n me mbeshtjetjen e njesive perkatese; Te aplikohen procedurat administrative dhe te mirembahet arkiva ne perputhje me rregulloret e ARSH-s; Te pergatiten reporte sic kerkohet dhe te raportohet per menaxhimin e perdoruesve rrugore; Stafi te beje vleresimin dhe monitorimin ne perputhje me qellimet e punimeve; Te mbeshtetet zbatimi i programit te kapacitetit ndertues te burimeve njerezore per Njesine.

SHTOJCA III
KATEGORITE E STAFIT TE PROPOZUAR

Njesia	Menaxheri I Pergjithshem	Drejtori	Shefi I Njesise	Keshilltar i Ligjor	Oficeri I projekteve/ Specialisti	Oficeri I Prokurimeve	Llogaritar	Administratori / Sekretare	Shoferi	Ne Total
Njesia e Sherbimeve Rajonale	1			1	2			1	2	7
Njesia e Sherbimeve Rajonale the Veriut dhe Jugut (RS)			2					1	2	5
Njesia e Prokurimit			1			2				3
Njesia e Zbatimit te Projekteve			1		4					5
Njesia e Sigurise se Cilesise	1							1	6	8
Njesia e Sigurise Rrugore			1		1					2
Njesia e Operimeve			1		6					7
Njesia Sociale dhe Ambjentit			1		2					3
Njesia e Planifikimit	1				2			1	1	5
Njesia e Sistemit te	1				1			1	1	4
Drejtoria e Burimeve	1				1			1	1	4
Drejtoria e Finances	1		1		4		2	1	1	10
Drejtoret ne Total	6	0	8	1	23	2	2	7	14	63
Njesia e Projekteve te	1		7	1	7	3	2	1	3	25
Rajonet		12	36		12	12	12	12	30	126
ARA ne Total	7	12	51	2	42	17	16	20	47	214

SHTOJCA IV
BUXHETI I DPRR NGA 2000 DERI NE 2007

Buxheti i DPRr nga viti 2000 deri ne 2007								
Description	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Ndertim Rrugesh	257,863	1,513,489	1,451,319	1,764,500	4,753,270	2,156,320	13,677,725	19,507,267
Sistemime Asfaltime	86,000	450,051	638,794	806,000	1,100,713	1,528,492	2,899,947	2,192,450
Riveshje Pjesore	199,377	506,772	297,161	194,500	13,337			
Ndertim urash	39,000	404,748	72,100	126,500	92,271	208,000	466,885	318,500
Ndertim / Blerje Zyrash	11,000	9,200	5,000	20,726	1,967	19,100	17,719	
Ndertim vepra arti	29,500	75,596	192,202	93,500	115,889	145,000	259,001	51,000
Studim Projektim	51,900	95,539	87,184	70,000	153,000	150,074	245,757	701,143
Makineri pajisje	5,000	5,268	7,000	10,000		5,900	6,703	
Supervizion		42,439	67,266	74,000	124,391	82,214	88,376	415,015
Sistemi asfaltim					125,000	115,600	229,299	112,000
Siguri Rrugore						133,000	117,818	370,000
Shuma	679,640	3,103,102	2,818,026	3,159,726	6,479,838	4,543,700	18,009,230	23,667,375
Financime nga pale te tjera	376,112	671,490	426,000	454,000	419,662	390,000	473,251	550,000
TVSH	1,417,400	1,938,435	810,000	686,000	622,266	476,600	578,803	1,041,512
Shpronesime	986,488	328,308	574,000	660,000	654,222	519,300	533,871	50,000
Ne total	2,780,000	2,938,233	1,810,000	1,800,000	1,696,150	1,385,900	1,585,925	1,641,512
Mirembajtje	509,500	733,400	874,000	743,000	832,317	806,900	947,473	1,117,000
Investime te huaja	7,087,000	9,692,175	4,050,000	3,430,000	4,664,000	3,276,800	2,819,405	13,561,886
NE TOTAL	11,056,140	16,466,910	9,552,026	9,132,726	13,672,305	10,013,300	23,362,033	39,987,773

SHTOJCA V
TER PER ZBATIMIN E PLAN VEPRIMIT

TERMAT E REFERENCES

Sherbimet e konsulences ne mbeshtetje te Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacioneve per te formuar Autoritetin e Rrugeve Shqiptare

SHQIPERIA

1. Hyrie

73. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve (MPWTT), ne emer te Qeverise se Shqiperise kerkon te behen sherbimet nga nje kompani e kualifikuar konsulence per te mbeshtetur Njesine e Zbatimit ne formimin e Autoritetit te Rrugeve Shqiptare (ARSH), Nje Ent me aftesi te percaktuara Shtetore qe operon ne perputhje me ligjin shqiptar Brenda fushes administrative te MPPTT. ARSH do te jete pergjegjese per mirembajtje, rehabilitim, riveshje, ndertim dhe nderhyrje te Rrugeve nacionale te Klasit I dhe II.

74. Rrjeti i rrugeve ne Shqiperi kap ne total rreth 14,500 km, qe perfshin 3,136⁶ km rruge nacionale, nga te cilat 1,138 km jane rruge kryesore, dhe 2,274 km jane rruge sekondare. Ka rreth 4,411 km rruge lokale, prej te cilave 3,500 km jane hyrjet e qyteteve ose daljet dhe 4,980 km jane rruge komunitare. Rreth 3,000 km te rrugeve locale jane rruge zhavorri. DPRr ka ne pune nje staf prej 580 vetesh; 105 punojne ne zyrtat drejtuese ne Tirane, me nje staf teknik prej 160 vetesh dhe rreth 315 punetore jane te shperndare ne 12 drejtorite rrugore rajonale.

75. Me perfundimin e studimit te Planit te Transportit Nacional Shqiptar (ANTP) eshte propozuar nje structure dhe proces reforme per DPRr, e pergatitur me financimin e Bashkimit Europian. Qeveria ka pershtatur studimin e ANTP sipas vendimit Nr 270 ne Maj te vitit 2006.

76. Si rrjedhoje eshte angazhuar asistenca teknike e Bankes Boterore (WB)⁷ per te ndihmuar MPPTT qe te zhvilloje me tej kuadrin institucional dhe te percaktojte procesin e zbatimit. Ky projekt ka pergatitur nje plan veprimi qe mundeson 'harten rrugore te pershtatshme' per te transformuar DPRr ne nje Ent Publik me modern, efektiv dhe sa me eficient. (kopjet e ketyre studimeve do te mundesohen per gjithe konsulentet e perzgjedhur).

77. Njesia e zbatimit te MPPTT do te menaxhoje kete transformim dhe transferimin e rrjetit nacional rrugor nga DPRR ne ARSh. Njesia e zbatimit e mbeshtetur nga Konsulenti, do te promovojte vazhdueshmerine dhe castin e zbatimit te ketij plani dhe do te siguroje faktin qe jane zbatuar totalisht gjithe rekomandimet me te nevojshme.

2. Objektivat dhe Detyra

78. Objektivat e TA jane qe te asistojte ne njesine e zbatimit, te perforcoje menaxhimin rrugor nacional nga hyrja e shume proceseve menaxhuese rrugore qe jane me te pershtatshme dhe efikase dhe te permiresojte kualitetet dhe aftesite e punonjesve te ARSh. Arritja e ketyre objektiveve do te kontribojte ndjeshem ne arritjet e Qeverise drejt objektiveve sociale dhe ekonomike. Sherbimet e konsulentit do te kryhen per nje periudhe 18 mujore. Me te perfunduar kjo periudhe, ARSh do te jete teresisht operuese dhe pergjegjese per menaxhimin e rrugeve nacionale.

79. Veprimtarite me themelore qe do kryhen nga konsulenti jane:

- Te asistojte MPPTT ne pergatitjen e akteve te brendshme dhe dokumentacion te ngjashem per skemen e re dhe te asistojte ne perzgjedhjen e stafit;

- Te permblede kuadrin rregullator per sektorin e rrugeve, legjislacionin e ri te rekomanduar dhe te asistojte MPPTT per parapergatise nje legjislacion te ri ose te permiresojte legjislacionin ekzistues;

- Te pergatise Planin Strategjik, me priritet ne projektet rrugore dhe projektimet buxhetore ne vazhdim per ndertimin dhe mirembajtjen brenda nje Kuadri Shpenzimesh Afat Mesem (MTEF);

- Hyrja e kerkesave per sistemin e informacionit (IS), pergatitja e nje Master Plani IS dhe instalimi i programeve hardware dhe software;

- Pergatitja e sistemeve te menaxhimit per Burimet Njerezore, Programet e Kontabilitetit dhe

⁶ Permbledhje e klasifikimit rrugor eshte bere brenda kuadrit pergatitor te Projektit te Bankes Boterore te Rrugeve sekondare dhe lokale gje qe mund te sjelle rritjen e permasave te Rrjetit Nacional Rrugor.

⁷ Projekti i Transportit (TP) Kredia Nr. P0787949

Monitorimin e Projektit;

- Njohja me nje llogaritje per programme trajnimesh;
- Pergatitja e manualeve operuese me dokumentat standarte dhe procedurat operuese;
- Zbatimi i programit per formimin e kapaciteteve.

3. Qellimi i Sherbimeve

80. Sherbimet qe do kryhen duhet te permbajne:

Detyra 1 – Asistojte me Dokumentacion dhe Perzgjedhe Stafin

81. Te asistojte ne pergatitjen e marreveshjes se sherbimeve ndermjet Qeverise dhe ARSh qe percaktohet qarte (i) fuqia dhe autoriteti i deleguar, (ii) pergjegjesite dhe gjithe masat e kryerjes se puneve, (iii) evidence e bordit menaxhues te ARSh, (iv) udhezime te burimeve njerezore, (v) nivelet e financimit nga burimet qeveritare, dhe autoriteti per te thithur financime shtese me ane te taksave dhe tarifave te tjera nga perdoruesit rrugore.

82. Te mbeshtese njesine e zbatimit ne pergatitjen e dokumentacionit te brendshem per ARSh duke perfshire rregulloret dhe procedurat operuese ne perputhje me strukturen e re dhe ambjentin operues;

83. Te mbeshtese njesine e zbatimit me (i) vendime ne sherbimet e zyrave, duke perfshire transferimin e arkivave, pajisjeve dhe pergjegjesine e DPRr ne ARSh dhe permriesimin drejt sherbimeve me moderne te zyrave, (iv) perforcimin e teknologjise se informacionit, (iv) mbeshtetje per perzgjedhjen e stafit, duke perfshire pershkrimin e pozicioneve, kualifikimet perkatese dhe kandidatet me te mudnshem.

Detyra 2 – Permbledhje e kuadrit rregullator dhe ndihma per legjislacion te ri

84. Ne perputhje me Institutin e Transportit te MPPTT te permbledhe kuadrin ekzistues rregullator qe drejton veprimtarite e sektorit rrugor, duke perfshire sherbimet e prokurimit, regjistrimin e tokes dhe shpronесimet, qe zene vend ne rrjetin rrugor, dimensionet e makinerive dhe kontrollin e peshes, sigurine rrugore, mbrojtjen ambjentale dhe autoritetin rregullator. Te pergatise nje raport qe permbledh gjithe dobesite ne legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e rregulloreve dhe masave perforcuese te propozuara.

85. Per masat e miratuara nga MPPTT, legjislacioni i ri parapergatitor, axhenda per legjislacionin ekzistues ose duhen marre parasysh nga MPPTT dhe Keshilli I Ministrave edhe rregulloret e zbatuara per rastin e nje ligji te ri.

Detyra 3 – Pergatitja e Planit Strategjik (SOP)

86. Te permbledhet rruga e DPRr dhe gjithe te dhenat baze te trafikut dhe inventari I te dhenave rrugore i grumbulluar deri me sot ne Sistemin e Menaxhimit per Vleresimin e Rrugeve (RAMS)⁸. Te pergatitet nje plan dhe llogaritje e kosos per grumbullimin e te dhenave shtese qe nevojiten per SOP. Me miratimin e Njesise se Zbatimit, te kontraktohet nje kompani vendase per te bere inventarin e rrugave dhe kushtet e vleresimit te tyre me gjitheurvejimet e trafikut. Kostot e te dhenave te grumbulluara nga konsulentet do te paguhen me fonde shtese qe jane te disponueshme per kete detyre.

87. Te pergatitet nje plan strategjik per zhvillimin e rrugave, rehabilitimin dhe mirembajtjen per nje periudhe prej 10 vjetesh. Si pjese e SOP, te krijohet nje sistem te dhenash rrugore qe eshte i krahasueshem me Master Planin e Sistemit te Informacionit (Detyra 4) te future ne nje platforme GIS.

88. Te shfrytezohen mundesite ne angazhimin e konsulenteve lokale per rinovimin e metejshem te SOP duke perfshire inventaret dheurvejimet e kushteve rrugore, mirembajtjen dhe programet e rehabilitimit dhe pergatitjen e termave te references per ARSh qe te kontraktoje te tilla sherbime sic kerkohet.

Detyra 4 – Pergatitja e nje Master Plani IS dhe Instalimi i sistemit Hardware

89. Ne bashkepunim me MPPTT dhe Institutin e Transportit te pergatitet nje master plan IS per ARSh. Te instalohet teknologjia e informacionit me aftesine e rrjeteve te punes brenda ARSh me ane te nje serveri, sistemit ne rrjet dhe komunikimit hardware. Kostot e sistemit hardware te teknologjise se informacionit do te shtohen ne fondet e mundshme per kete detyre.

Detyra 5 – Ecuria e Sistemeve Menaxhuese

90. Te pergatitet dhe te vihet ne operim nje Sistem Kontabiliteti dhe Monitorimi per Projektet

⁸ RAMS eshte eprgatitur nga konsulentet e punesuar nga MPPTT me financime Europiane.

(FAPMS) me gjithë aftësisë e të komunikuarit online me zyrat drejtuese dhe një strukturë të përshtatshme për hyrjen e të dhënave në Rajone për të zotëruar informacion menaxhues për proceset me themelore. Të bëhet një test pilot në një nga rajonet e ARSh dhe zyrat drejtuese që të bëjë modifikimet e mundshme dhe trajnimet për gjithë stafin e ARSH-s që të përdorë këtë sistem. Përberësit e sistemit do të përfshijne:

- Një përberës raportues që mundëson informacion për gjithë punimet e përfunduara, shpenzimet kundrejt programit, dhe buxhetin për secilin projekt;

- Një sistem të kompjuterizuar kontabiliteti për të regjistruar gjithë të dhënat e shpenzimeve, përgatitjen e raporteve financiare, analizën e kostove dhe shpenzimet duke i krahasuar me buxhetin.

91. Të përgatise dhe operojë me një Sistem Menaxhimi për Burimet Njerezore (HRMS) dhe të dokumentojë sistemin në një Plan Strategjik Operacional që përfshin:

- Marrëdhëniet e ndërsjella dhe funksionet e detajuara dhe përgjegjësitë e zyrave drejtuese dhe njësive rajonale në lidhje me organizatat e tjera në sektor,

- Përkrahimin e vendeve të punës dhe përcaktimin e aftësive që nevojiten për të ardhurën në punë;

- Procedurat për vlerësimin e stafit dhe përcaktimin e objektivave të punës;

Detyra 6 – Njohja me Llogaritjen e saktë të Trajnimeve

92. Të bëhet një llogaritje për kërkesat e trajnimit që i drejtohen aftësive themelore që kerkohen për nivele të larta pune:

- Aftësi themelore të burimeve njerezore – parimet menaxhuese, udhëheqjen e punës, delegimin, menaxhimin e kohës dhe komunikimin;

- Prokurimin e aftësive për shërbime themelore – përfshirjen e rreziqeve, përgatitjen e termave të referencës, tenderimin, vlerësimin dhe shpronësimin;

- Aftësi për sigurimin e cilesisë – që përfshijne rolet dhe përgjegjësitë e enteve kontraktuale, administrimin e kontratës, planin e sigurimit të cilesisë, testing të materialeve, standartet e projektimit dhe përmbledhjen e projektit;

- Aftësi kompjuterike – që përfshijne operimin, daljen e veshtiresive dhe paketat e prodhimitarise së zyres që është bërë nga ARSh siç janë programet excel dhe word;

- Operimin e sistemeve të menaxhimit të ARSh duke përfshirë FAPMS, Të dhënat baze të Planifikimit dhe RAMS.

Detyra 7 – Përgatitja e Manualeve

93. Përgatitja e manualeve që dokumenton udhëzimet operuese për menaxhimin e të dhënave baze planifikuese dhe FAPMS.

94. Përgatitja e Manualit të Supervizionit dhe Ndërtimit që dokumenton rolet dhe përgjegjësitë e sigurimit të cilesisë për Kontraktorin, Inxhinierin dhe Punëdhënësin në përputhje me format e kontratës së ndërtimit të miratuar për Shqipërinë që përfshin seksionet që i drejtohen: (i) roleve të paleve të Kontratës së Ndërtimit, (ii) llojeve dhe shembujve të korrespondencës për secilën palë të kontratës, (iii) përmbledhje dhe monitorim në ndërthurje me planin e sigurisë së kontraktorit dhe (iv) përputhshmëri me standartet sociale, ambiente dhe sigurinë rrugore

95. Rishqyrtim i Manualit të Projektit të përgatitur me financimet Europiane dhe modifikimi i manualit nëse kerkohet për të rregulluar ambientin e ri të punës së ARSh.

Detyra 8 – Zbatimi i Programit të Ndërtimit të Kapaciteteve

96. Të përgatitet një plan trajnimi si dhe programme trajnimi për të drejtuar kërkesat për stafin e ARSh si edhe entet e sektorit privat që bëjnë biznes me ARSh. Programi i trajnimit duhet të përfshijë një listë të kurseve dhe të nenvizojë kurrikulen. Të identifikojë alternativat për shpërndarjen e trajnimeve (lokale ose institucionet nacionale të trajnimit, trajnime në punë, dhe kurse specializimi që i bën Konsulentin). Të përgatise llogaritjen e kostove për shpërndarjen e programeve të trajnimit për gjithë stafin e ARSh. Të asistojë ARSh të zbatojë gjithë kurset e fazës së parë. Kostot e prezantimit të trajnimeve për stafin e ARSh nëpër institucione do të ekene fonde shtese që do jënë të disponueshme për këtë detyrë. Sektori privat do të mbulojë kostot për trajnimin e stafit të tyre.

97. Të asistojë ARSh në përgatitjen e një llogaritje për kostot e trajnimeve të përhershme dhe programet e trajnimit.

4. Shërbime Mbeshtetese

98. Konsulenti do të jetë përgjegjës për kostot e qëndrueshme që do jënë të disponueshme për

akomodimin e zyrave me ngrohje, ndricim, elektricitet, dhe telekomunikacion. Konsulenti do paguaje transportin lokal dhe mbeshtetjen e zyrave. Nese kerkohet, MPPTT do asistoj konsulentin ne perzgjedhjen e stafit qe flet te dy gjuhet (Shqip-Anglisht) sekretari/asistence tjeter ne rast se eshte konsulent i huaj, por qe konsulenti do jete pergjegjes per pagesen e kesaj asistence.

5. Rezultatet e Pritshme nga Detyra

99. Konsulentet do pergatisin per Njesine e Zbatimit te MPPTT **Raportet e ecurise katermujore** per implementimin e punes duke perfshire arritjet dhe problemet qe duhen zgjidhur, rekomandimet, dhe sugjerimet per zgjidhjen e tyre. Raportet katermujore do te analizojne statusin e gjithë dative perkatese per paraqitjen e raporteve dhe objektivat e metejshme. Nje muaj perpara perfundimit te sherbimeve te tyre, konsulentet do te pergatisin nje raport perfundimtar paraprak qe mbulon gjithë detyrat e kerkuara nga TER. Raporti perfundimtar do te pergatitet brenda 15 ditesh pas marrjes se komenteve nga MPPTT.

100. Konsulentet duhet te pergatisin **raporte specifike dhe te ngjashme ne perputhje me termat e references.**

101. Konsulenti do te paraqese **Raportin Perfundimtar Draft** duke mbuluar gjithë kerkesat e TER nje muaj para se te perfundoje sherbimet. Konsulenti do paraqese kater kopje te raportit (te printuara) ne gjuhen Shqipe dhe kater kopje te printuara ne gjuhen Angleze per Njesine e Zbatimit te MPPTT, si edhe kopje elektronike net e dyja gjuhet.

102. Raporti Perfundimtar duhet te paraqitet dy jave pasi t emerren komentet nga pala kontraktuese. Konsulenti do paraqese kater kopje te printuara te Raportit Perfundimtar ne gjuhen Shqipe dhe kater kopje te printuara ne gjuhen Angleze per Njesine e Zbatimit te MPPTT, si edhe kopje elektronike net e dyja gjuhet.

103. Konsulenti do mundesoje kopje elektronike te te gjitha shenimeve te punes dhe materialeve teknike qe jane pergatitur gjate projektit te transformimit dhe gjithashtu ato duhet te jene ne formatin e tyre elektornik origjinal (p.sh. word processor, spreadsheet dhe database).

6. Kerkesat per Burime

104. Me poshte eshte permblodhur nje llogaritje e burimeve qe kerkohen per te kontribuar ne arritjen e detyrave te mesiperme.

SPECIALISTI	SECILIN MUAJ	
	NDERKOMBETAR	LOKAL
DREJTUES NJESIE /PLANIFIKIMI	15	
ZV. DREJTUES NJESIE/ INSTITUCIONAL		18
SPECIALIST LIGJOR		8
PLANIFIKIMI/INVENTARI		36
BURIMET NJEREZORE	4	30
SISTEMET E INFORMACIONIT	6	30
TRAJNIME		18
MENAXHIMI FINANCES/LLOGARITJE	6	24
INXHINIER CIVIL	4	24

APPENDIX VI TIP KONTRATE PER SHERBIMET

Nje pershkrim i tipit the marreveshjes se propozuar per nivelin e sherbimeve ndermjet MPPTT dhe Autoritetit Shqiptar te Rrugeve⁹

1 Hyrje

Autoriteti Rrugeve Shqiptare (ARSh) eshte Nje Kompani me aftesi te limituara Shteterore e

⁹ E pershtatur nga nje marreveshje sherbimesh qe eshte pergatitur nga Z. Richard Robinson, Banka Europiane per Rindertim dhe Zhvillim

pershtatur me Ligjin Nr. te dates qe operon brenda fushes administrative te Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacioneve (MPPTT). ARSh do drejtohet nga nje bord i Qeverise dhe drejtuesit e Shfrytezimit Rrugor. Ministri ose personi i percaktuar nga Ministri duhet te jete Kryetari i Bordit te Menaxhimit.

2 Politika dhe kuadri legjislativ

Udhezuesi per menaxhimin e rrjeteve te ndryshme rrugore brenda vendit eshte

Kodi Rrugor qe i perkon Ligjit te date 22 Korrik 1998 (Ligji Nr. 8378) dhe i publikuar ne Prill 2001.

2.1 Politika e Qeverise

Qeveria e Shqiperise ka nenvizuar perberesit kryesore te politikës se saj te transportit ne nje document te pergatitur per Komisionin e Deputeteve, Konferencen Europiane te Ministrave te Transportit (E.C.M.T), ne 1996. Objektivat me kryesore te radhitura ne kete politike jane:

- Te zhvillohet dhe rehabilitohet rruga, hekurudha, porti dhe infrastruktura e aeroporteve dhe sigurimi i burimeve financiare te nevojshme per te zhvilluar sistemin ne nje menyre me te harmonizuar qe te mbeshtese dhe inkurajoje zhvillimin e ekonomise se vendit dhe te perputhet me kerkesat e Transportit European ne rajonin jugor te Europes;

- Per te zbatuar reformat ekonomike, permes promovimit te privatizimit se veprimtarive t mbetura, tregtimin e sherbimeve publike, si edhe permes rritjes se kosos mbuluese me ane te nje cmimi dhe politikës se taksave;

- Per te krijuar nje system ligjor dhe rregullator ne perputhje me kerkesat europiane dhe standartet qe do te sigurojne operim sa me optimal ne bazat e nje konkurrence teper te larte;

- Per te zhvilluar dhe ndermarre reformat institucionale ne te gjitha sektoret e transportit.

[kjo eshte nje politike e artikuluar ne studimin e ANTP]

2.2 Hapesira legjislative

Kodi Rrugor detajon funksionet, fuqizon dhe pergjegjesite e Ministrit te MPPTT me te cilat do te perputhet ARSh.

2.2.1 Funksionet e Ministrit te MPPTT

Funksionet, fuqite dhe pergjegjesite e Ministrit me te cilat do perputhet ARSh qe do perfshije:

-
-

[perfshin artikuj perkates nga kodi rrugor dhe rregulloret e zbatimit]

2.2.2 Funksionet e Drejtorise se Pergjithshme te Politikës dhe Planifikimit per Transportin dhe Telekomunikacionet

Drejtoria e Pergjithshme e Politikës dhe Planifikimit per Transport dhe Telekomunikacionet (GDPPTT) gezon funksionet, fuqite dhe pergjegjesite qe perfshihen me poshte:

[te percaktohen funksionet e statusit, fuqite ose pergjegjesite e caktuara per GDPPTT]

2.2.3 Funksionet e deleguara per Bordin e Menaxhimit te ARSh

2.3 Politikat Ministrore

MPPTT eshte pergjegjese per formulimin e politikës dhe permbledhjen e sektorit te transportit, duke balancuar interesat e gjithe aktoreve te interesuar si edhe nevojat ekonomike, ambjentale dhe sociale te njerezve dhe vendit

Misioni

Misioni i MPPTT eshte qe te “zhvilloje nje politike transporti dhe nje kuader qe siguron sektorin e transportit per meshume eficience, siguri, akses, qendrueshmeri dhe perputhet me gjithe objektivat e zhvillimit ekonomik dhe nevojat sociale te njerezve”.

[ky eshte misioni i propozuar nga ANTP]

Objektivat strategjike

Objektivat strategjike te MPPTT, ne lidhje me poltikat e nen sektorit rrugor jane qe te:

- Te kontribojne drejt nje zhvillimi ekonomik te balancuar dhe procesin e stabilizimit rajonal dhe lidhjen me ane te permiresimit strategjik dhe zhvillimit te rrjetit te rrugeve nacionale;

- Te mbroje investimin ne vend me asetet rrugore me ane te drejtimit te agjensive egzekutuese qe japin rendesine e duhur per mirembajtjen rutine dhe periodike te rrjetit rrugor;

- Te mbeshtesin efektivitetin dhe eficiencen e shperndarjes se sherbimeve nga perfshirja e

sektorit privat;

- Te stabilizohet politika ne lidhje me sigurine rrugore dhe planifikimin ambjental, projektin, ndertimin dhe operimin ne rrjetin rrugor;

[Rishqyrtim dhe modifikim /sic kerkohet]

2.4 Perkufizimi i rrjetit

ARSh eshte pergjegjese per menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit te rrugeve nacionale qe I perkasin Klases I dhe Klases II Rruget Nacionale. Shtojca permban nje liste te rrugeve ne te cilat eshte pergjegjese ARSh.

2.5 Aktoret e Interesuar

Klientet

ARSh ka kliente grupet e meposhtme:

- Ministrin MPPTT
- Perdoruesit rrugore, duke perfshire
- Qytetaret e Shqiperise qe perfitojne direkt ose indirekt nga lidhja me rrjetin rrugor nacional,
- Udhetime publike ne rrjetin rrugor nacional,
- Pronaret dhe shoferet e automjeteve tregtare dhe autobuseve
- Pefaqesuesit e industrise, tregtise dhe bujqesise, qe kane nje interes te venitur ne rrjet me te mire rrugor per te mbeshtetur sa me shume bizneset e veta

Aktore te tjere te interesuar

Pervec kesaj, ARSh njeh edhe aktore te tjere ne bizneset e saj. Keto perfshijne:

- Industrin inxhinierike rrugore te kontraktoreve dhe konsulenteve
- Stafin e ARSh dhe varesit e tyre
- Investitoret e tjere, pronaret dhe agjensite financuese

2.6 Politika e ARSh

Kuadri I politikave te ARSh

ARSh do percaktoje nje kuader politikash, qe duhet te nenvizojte gjithë planin e saj te bashkepunimit, brenda kuadrit te politikave qe eshte percaktuar nga MPPTT.

Misioni

Misioni I ARSh mbetet qe te kontribojte drejt nje standarti me te mire jetese per gjithë njerezit ne Shqiperi me ane te nje rrjeti rrugor nacional sa me te sigurte dhe te qendrueshem.

Qellimi dhe Objektivat

Arritja e qellimit kryesor te ARSh mbetet sigurimi I rrjetit rrugor qe perputhet me Standartet e Bashkimit European, duke krijuar keshtu nje linje teper vitale e Rrjetit Trans – European dhe kontributin per zhvillimin ekonomik dhe kushte me te permiresuara jetese. Per te mbeshtetur kete qellim ARSh do aplikojte sa me mire burimet qeveritare dhe do prokuroje sa me ekonomikisht sherbimet e planifikuara, ndertimin, mirembajtjen dhe operimin e rrjetit nacional rrugor;

3 Burimi dhe kuadri i planifikimit

3.1 Marreveshjet financuese

Burimi i financimit

Financimi aktual per rruget mundesohet nga buxheti i shtetit per ARSh. Ky nen sektor eshte mbeshtetur nga nje numer shume i madh donatoresh dhe agjensish huadhenese nderkombetare.

Auditi

Shfrytezimi i te gjitha financimeve te ARSh do jete tema e auditit vjetor nga auditues te pavarur qe jane zgjedhur nga komonai audituese teper te njohura nderkombetare si edhe audit i brendshem [?]

3.2 Programi shpenzimeve

Qendrueshmeria e financimit

Sipas mendimit te Minsitrit duhet te sigurohen financime te sakta dhe te qendrueshme per punimet rrugore, vecanerisht punimet e mirembajtjes ne perputje me planet strategjike te investimit te pergatitura nga ARSh dhe te mratuara nga MPPTT.

Prioritete te pergjithshme

Punimet ne rrjetin rrugor duhet te financohen sipas rregullit te pergjithshem te prioriteteve:

1. Mirembajtja rutine dhe periodike

2. Rehabilitimi
3. Permiresimi dhe nivelimi (punimet e investimeve kapitale)

Alokimi i fondeve

Qeveria do alokoje fondet, duke u bazuar ne te tilla qellime dhe prioritete qe stabilizohen nga planet strategjike te pergatitura nga ARSh, ne nje menyre qe siguron shperndarjen e fondeve ne dispozicion.

Planifikimi Investimit

[emerto ligjin qe stabilizon ARSh] kerkon qe ARSh te pergatise dhe te rinovojë planet strategjike si edhe programet vjetore te punimeve rrugore. Planet strategjike do mbulojnë nje hapësirë prej dhjete vjetesh investime. Programi vjetor i ARSh per punimet rrugore do te rishqyrtohet nga Ministria, e cila do pergatise programet e punes per mirembajtjen dhe zhvillimin e ARSh.

3.3 Financimet e jashtme

Qeveria mund te kerkoje fonde me kalimin e kohes nga burime te jashtme, mbi bazen e periudhave te cakturara, qe te asistojë me zhvillimin dhe rehabilitimin e rruges.

3.4 Kuadri planifikues

Plani bashkepunimit

Cdo vit, ARSh do pergatise planet e bashkepunimit dhe biznesit per tu miratuar nga Ministri. Plani I bashkepunimit do percaktojë strategjit kryesore te ARSh, objektivat dhe burimet e projektimit per nje periudhe pese vjecare, dhe do krijojë nje kuader planifikues te rene dakort per Departamentin. Plani do te shtrihet ne periudhen e metejshe dhe do te rinovohet per cdo vit me nje table te caktuar kohore qe kerkohet nga nje permbledhje e shpenzimeve publike.

Plani i Biznesit

Plani i biznesit do shfrytëzojë tendencat dhe sugjerimet e vena ne planin e bashkepunimit, dhe do percaktojë objektivat me specifike te ARSh, masat e punes dhe planin financiar per kater vitet e ardhshme financiare, dhe gjithë menytrat qe keto do permblushen. Puna e ARSh do gjykohej kundrejt objektiveve dhe masave te punes qe jane percaktuar ne planin e biznesit qe do publikohet.

3.5 Raportimi dhe pergjegjesia

ARSh do publikojë nje raport vjetor per klientet e saj, formatin me te cilin do bjere dakort ne drejtimin qe do kete nga Ministria e Finances dhe kerkesat e MPPTT. Raporti do te shqyrtojë operimin e ARSh ne vitet qe pasojne, dhe do sigurojë detajet e punes kundrejt objektiveve dhe masave te punes.

4 Kuadri per pergjegjesine

4.1 Ministri

Fuqite, pergjegjesite dhe ndergjegjesimin e pergjegjesise se Minsitrit per transportin jane percaktuar ne Kodin Rrugor. Keto jane permbledhur ne Nen-seksionin 2.2.1.

4.2 Bordi i Menaxhimit

Perberja e Bordit te Menaxhimit

Agjensite e meposhtme qeveritare do emerojnë nje anetar per tu anetaresuar ne Bordin e Menaxhimit:

- Ministria e Finances
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjise
- Prefekturat

Organizmat e aktoreve te interesuar qe jane radhitur me poshte do te emerojnë nje person, qe do miratohet nga Ministri, per ti bere sherbime Bordit te Menaxhimit:

- Shoqata e Transportit Rrugor
- Shoqata e Perdoruesve Rrugore [organizem I vecante qe do percaktohet nga RIT]
- Dhoma e tregtise dhe Industrise
- Shoqata e Kontraktoreve.

Termat e Sherbimit te Bordit te Menaxhimit

Anetaret e sektorit qeveritar te sherbejnë per ti gjykuar me pas Ministri qe i cakton ata ne pune. Anetaret qe perfaqesojne organizatat e aktoreve kryesore do sherbejnë per te gjate pese viteve dhe mund te emerohen per nje maksimum prej dy vjetesh. Per te promovuar vazhdimësinë dhe menjëherë rizevendësimin e gjithë anetareve te bordit te aktoreve kryesore ne te njejtën kohë, kur stabilizohet ARSh, atëherë kohezgjatja ne postet e perfaqesuesve nga ana e aktoreve kryesore ne

Bordin e Menaxhimit do te jete si me poshte:

- Shoqata e Transportit Rrugor – 2 vjet
- Shoqata e Perdoruesve Rrugore – 3 vjet
- Dhoma e Tregtise dhe e Industrise – 4 vjet
- Shoqata e Kontraktorit – 5 vjet

Anetaret e Bordit nuk duhet te jene anetare te organizates qe emeron ata dhe nuk duhet te bejne biznes me ARSh ose MPPTT.

Forumet dhe Vendimet e Bordit te Menaxhimit

Vendimet e Bordit te Menaxhimit do te behen me votat e shumices me te pakten pese anetare prezente. Ne rastin e nje ngaterrese Ministri i MPPTT do shperndaje voten e vendimit.

Roli i Bordit te Menaxhimit

Bordi i Menaxhimit do jete pergjegjes per menaxhimin strategjik te ARSh duke perfshire vendimet e stafit, politiken operuese dhe shpenzimet. Anetaret do kene akses personal te Ministri per cdo ceshtje qe ka te beje me ARSh; dhe Bordin qe do konsultohet para cdo lloj propozimi, duke perfshire politikat e vendimeve, do adoptohen dhe menyrat e sjelljes ne punen e ARSh. Pergjegjesite e vecanta perfshijne:

- Emerimin, punen e mire dhe nese duhet deri ne heqjen nga puna te drejtorit ekzekutiv (CEO) dhe stafin e rendesishem;
- Stabilizimin e qellieve te ARSh, objektivat strategjike, dhe planet e bashkepunimit dhe te biznesit,
- Monitorimi i punes se ARSh kundrejt qellimeve dhe objektivate strategjike ne planet e bashkepunimit dhe biznesit, dhe vendimeve ne veprimet qe duhen per qellimet e bashkepunimit,
- Ushtrimi i autoriteteve te tilla financiare, kontraktuale dhe menaxhimin e personelit ne lidhje me ARSh, qe nuk i delegohen Presidentit ose CEO se ARSh,
- Se bashku me Presidentin dhe CEO e ARSh, kerkohet qe interesat e ARSh te prezantohen tamam brenda Ministrise dhe me gjere.

4.3 Menaxhimi Operues i ARSh

Fillimi i pergjegjesive

Pergjegjesite e Presidentit dhe CEO nisin nga pergjegjesite e Ministrit ne pergjegjesi Autoriteti per menaxhimin dhe mirembajtjen e Rrugeve Nacionale dhe per kete arsye ata pritet qe te bashkepunojne dhe mbeshtesin njeri tjetrin per arritjet e qellimeve dhe objektivate te ARSh. Cdo lloj pergjegjesie ministrore ne lidhje me rruget e tjera nuk ushtrohet nga Presidenti ose CEO e ARSh derisa te vendoset specifikisht dhe vecanerisht ndermjet Ministrit dhe menaxhimit te ARSh.

Roli i Presidentit te ARSh

Presidenti do sherbeje ne gjykimin e lire te Ministrit te MPPTT. Pergjegjesite specifike permbledhin:

- Keshillimin e Ministrit ne pune dhe ceshtjet e tjera qe lidhen me politiken strategjike dhe drejtimin e ARSh dhe te siguroje interesat e ARSh qe prezantohen brenda MPPTT dhe me gjere.
- Te perfaqesoje ARSh ne gjithe forumet publike lokale dhe nderkombetare si dhe ne raste te tjera,
- Te perfaqesoje ARSh para perdoruesve rrugore dhe klienteve te saj,
- Te organizoje fushata per keshillim, edukim dhe te marre informacion nga publiku ne lidhje me iniciativat qe promovojne sigurine rrugore, mbrojtjen ambjentale dhe sa me shume pune efikase gjate performances se ARSh,

Pergjegjesite specifike

CEO eshte pergjegjes per menaxhimin e perditeshem te ARSh dhe keshillon Ministrin dhe Bordin e Menaxhimit ne politiken operuese qe ndikon ne operimet e ARSh. CEO do te kete nje rol te rendesishem ne krijimin e rekamandimeve per Bordin e Menaxhimit rreth zhvillimit te rrjetit, duke perfshire rekomandimet ne propozimet rrugore ne lidhje me prioritetet. CEO eshte direct pergjegjes per Bordin e Menaxhimit ne kryerjen e punes dhe operimet e ARSh. Ne vecanti, CEO esht epergjegjes per:

- Pergatitjen e draft planeve te ARSh per bashkepunim dhe biznes, duke perfshire objektivat e rendesishme dhe paraqitjen e tyre ne Bordin e Menaxhimit,
- Arritja e objektivate kryesore te ARSh,

- Menaxhimi sa me i mire i burimeve te ARSh,
- Raportimi ecurise se punes rregullisht ashtu sic eshte rene dakort me Ministrin me kalimin e kohes

- Njoftimi i menjehershëm i Bordit te Menaxhimit mbi cdo pergatitje materiali ne baze te planeve te biznesit dhe buxhetit,

- Duke kerkuar miratim te vecante nga Bordi i Menaxhimit per cdo veprim ose iniciative qe mund te jete e diskuteshme,

- Informimi i Bordit te Menaxhimit mbi cdo ceshtje qe mund ngreje nje problematike publike shume te rendesishme ose parlamentare,

- Paraqitja e raportit vjetor dhe llogarite financiare, nga Bordi i Menaxhimit, te Ministri per publikimin dhe venien ne internet.

4.4 Pergjegjesite per shkarkimet

Gjate kryerjes se ketyre veprimtarive ARSh do te:

- Konsultohet gjeresisht me perdoruesit dhe aktoret e tjere te interesuar qe preken direkt nga infrastruktura per te cilet ata jane pergjegjes, duke perfshire departamentet e Qeverise, autoritetet lokale, dhe palet e tjera te interesuara,

- Te vepohet ne perputhje me planet e biznesit qe jane vendosur dhe buxhetet,

- Veprimi ne perputhje me politikat dhe iniciativat e Qeverise,

- Te sigurohet mbeshtetje e forte ne lidhje me keshillimin ne korrespondence dhe mund te kerkohet nje permblidhje ne varesi te kerkeses se Ministrit ose Bordit te Menaxhimit,

- Te sigurohet kordinim i duhur i veprimtarive nepermjet Qeverise dhe ne vecanti ne lidhje me vendimet qe prekin menytrat e tjera te transportit,

- Te ndermerren programet e duhura te kerkimeve dhe zhvillimit qe pasqyron misionin dhe objektivat e saj.

4.4 Personeli

4.4.1 Statusi

Stafi i ARSh do jete subjekt per normat e operimit, kompensimin dhe perfitimet e tjera sipas ligjit qe operon ne Shqiperi.

4.4.2 Kushtet e sherbimit

Termat dhe kushtet

Stafi do punesohet ne baze te termave dhe kushteve te sherbimit qe aplikohet per shoqatat e sektorit privat ne Shqiperi. Cdo ndryshim ne staf ose riorganizim kerkohet ne interesat e menaxhimit sa me efficient te ARSh qe do prezantohet vetem pasi te behen konsultimet me Bordin e Menaxhimit.

Pergjegjesia e deleguar

Bordi i Menaxhimit do delegoje pergjegjesite e menaxhimit te personelit per CEO-n.

4.4.3 Rikrutimi dhe promovimi

Rekrutimi i stafit dhe promovimi do miratohet nga procedurat e miratuara te permblidhura ne Sistemin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore te ARSh.

4.4.4 Mundesite e barabarta

ARSh do premtojte per sigurimin e barabarte dhe trajtim te drejte te gjithe stafit ne teresi dhe gjithë aplikantet qe do punesohen. Menaxheri I Pergjithshem I Burimeve Njerezore do jete pergjegjes per kete politike ne menyre qe te promovohet edhe me tej mundesia e barazise.

4.4.5 Shendetet dhe siguria

ARSh do premtojte qe do siguroje standarte shume te larta per shendetin dhe sigurine ne perputhje me statutin dhe kerkesat shteterore qe jane ne baze te ligjit per shendetin dhe standartet e sigurise. Menaxheri I Pergjithshem I burimeve njerezore do siguroje qe kjo kerkese eshte zbatuar ne teresi.

4.5 Qellimet dhe masat e punes

Qellimet dhe objektivat strategjike te RTSD jane percaktuar sipas asaj qe thuhet ne Seksionin 2.3. Arritjet kundrejt ketyre objektive do monitorohen me treguesit perkates te punes. Objektivat strategjike dhe punet perkatese te tyre jane treguar me poshte.

Objektiva Strategjike	Treguesi I Punimeve

[do vendoset ndermjet Bordit dhe CEO-s]	[do vendoset ndermjet Bordit te Menaxhimit dhe CEO-s]
---	---

4.6 Raportimi dhe marreveshjet e monitorimit

Bordi i Menaxhimit do monitoroje formalisht punen e ARSh ne baza vjetore. Raporti Vjetor i ARSh (i pershkruar ne Seksionin 3.5) do siguroje nje rezultat kyc per procesin, dhe do raportoje ne punen e gjithe treguesve qe do dalin perpara sic eshte pershkruar ne Seksionin 4.5.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 14.4.2008
 Doli nga shtypi më 16.4.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
 Tiranë, 2008

Çmimi 54 lekë